



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në
“Financë”**

ofruar nga

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Dr Artur Ribaj

2. Prof.Asoc.Dr Orkida Ilollari



Shtator / 2025

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për programin e studimit Master i Shkencave në “Financë” ofruar nga Institucioni
i Arsimit të Lartë Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Financë- Kontabilitet
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Financë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH Nr.575, shtojca 2.1 datë 20.11 2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 64, datë 15.03.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	13 PAE/ 0 PAK: V.A. 2023- 2024 13 PAE/ 0 PAK: V.A. 2022- 2023 13 PAE/ 0 PAK: V.A. 2021- 2022
18	Numri i studentëve:	10 - Studentë: V.A. 2023-2024 9 - Studentë: V.A. 2022-2023 9 - Studentë: V.A. 2021-2022
19	Komente / të tjera:	N/A

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, (UNIKO), i krijuar me VKM Nr. 5 dt.07.01.1992, bazuar në veprimtarinë e Institutit të Lartë Bujqësor të Korçës (1971-1992). UNIKO ushtron veprimtarinë akademike shkencore bazuar në Ligjin Nr 80/2015 të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor për IAL-të në Republikën e Shqipërisë. Programit i studimit të Ciklit të dytë Master Shkencor në "Financë" të ofruar nga Departamenti i Financë-Kontabilitet pranë Universitetit "Fan S. Noli" Korçë është hapur bazuar në Vendimin Nr.575, shtojca 2.1 datë 20.11.2012.

GVJ vlerësoi RVB, dokumentacionin e dorëzuar në mbështetje të këtij vlerësimi dhe kreu vizitën në IAL me qëllim plotësimin e detyrimit ligjor të parashikuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". GVJ konstaton se RVB me pak sugjerime është përgatitur në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë për akreditimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.

Programi organizohet sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe për të fituar këtë diplomë duhen 120 kredite (ECTS) në gjuhën shqipe. Forma e studimit në programin e studimit Master i Shkencave në "Financë" është me kohë të plotë dhe e organizuar në mënyrë të kujdesshme, për të harmonizuar të gjithë komponentët e tij, duke respektuar legjislacionin në fuqi lidhur me organizimin e programeve të studimit (VKM Nr. 41, datë 24.01.2018).

Objektivi kryesor i këtij programi është të përgatisë profesionistë të aftë për të përballuar me sukses kërkesat e tregut të punës, në drejtim të tregjeve financiare, biznesit, dhe institucioneve publike, pavarësisht dinamikave dhe ndryshimeve të vazhdueshme në ekonomi.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), i përcaktuar nga ASCAL për vlerësimin e jashtëm të këtij programi studimi, është i përbërë nga Prof. Dr. Artur Ribaj dhe Prof. Asoc. Dr. Orkida Ilollari, të cilët u asistuan gjatë procesit nga koordinatori teknik i ASCAL.

GVJ analizoi dokumentacionin e ofruar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) si dhe dokumente të dorëzuara nga institucioni. Një burim kyç në këtë proces ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), i hartuar nga stafi akademik dhe administrativ, i cili ofron një pasqyrë të detajuar mbi procesin e formimit dhe zhvillimit në Fakultetin e Ekonomisë (FE) dhe Departamentin e Financë-Kontabilitetit (DFK).

Gjatë vizitës në institucion në datat 5 dhe 6 Mars 2025, GVJ zhvilloi takime me drejtuesit e njësive kryesore dhe strukturave të tjera të Universitetit "Fan S. Noli" (UNIKO), duke shqyrtuar dhe verifikuar dokumentacionin përkatës të akreditimit të programit.

Takimet përfshinë intervista me hartuesit e RVB-së, anëtarët e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm (GVB), personelin drejtues, akademik dhe administrativ, si dhe studentët e programit të studimit. Përveç kësaj, GVJ kreu një inspektim të detajuar të ambienteve të UNIKO dhe infrastrukturës që i shërben programit.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) përfshin analizën e gjashtë fushave kryesore, ku secili standard është vlerësuar në përputhje me të dhënat e paraqitura në RVB, evidencat shtesë dhe materialet e shqyrtuara gjatë vizitës. GVJ ka analizuar ndikimin e ndryshimeve të bëra dhe përmbushjen e kriterëve të standardeve përkatëse. Për secilin standard, është dhënë një vlerësim i qartë mbi shkallën e përmbushjes, i shoqëruar me komente dhe rekomandime të detajuara.

Për verifikimin e të dhënave, u përdor metoda e marrjes së mostrës, duke zgjedhur në mënyrë të rastësishme kampionët për verifikim. Kjo metodë u aplikua në kontrollin e cilësisë së studentëve, të dhënave të regjistruara në sekretari, hyrje-daljet e studentëve ndër vite, frekuentimin e leksioneve dhe seminareve, si dhe në shqyrtimin e praktikave të rekrutimit të stafit.

Në përfundim, GVJ vlerëson bashkëpunimin me strukturat përkatëse të institucionit, të cilat siguruan dokumentacionin e nevojshëm për një vlerësim sa më objektiv dhe të plotë. Raporti është hartuar në bashkëpunim të ngushtë midis dy ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë mendimet e tyre të integruara mbi cilësinë dhe zhvillimin e programit Master i Shkencave në "Financë".

Më datë 27.06.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 36/80 Prot., datë 27.06.2025, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes

AMS, më datë 04.07.2025, dhe me shkresë zyrtare Nr. 1399/1 Prot., datë 04.07.2025, ka dërguar përgjigje mbi draft raportin, duke u shprehur se nuk ka komente, si rrjedhojë raporti, merr formen përfundimtare, si raport i vlerësimit të jashtëm.



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



LISTA E SHKURTIMEVE

ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
DFK	Departamenti Financë-Kontabilitet
DKVI	Drejtoria e Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional
FE	Fakulteti i Ekonomisë
GVB	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
GVJ	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm
IAL	Institucion i Arsimin të Lartë
MSH	Master Shkencor
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
PAE	Personeli Akademik Efektiv
PAK	Personeli Akademik me Kontratë
QKA	Qendra e Karrierës dhe Alumnit
RVB	Raport i Vlerësimit të Brendshëm
RVJ	Raport i Vlerësimit të Jashtëm
SBC	Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë
SKS	Sondazhi Kombëtar i Studentëve
SKVIA	Spektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumnit
SPK	Spektori i Projekteve dhe Kërkimit
UNIKO	Universiteti "Fan S. Noli" Korçë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Vlerësimi i programit të studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Financë"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Në përputhje me rregulloren e Universitetit "Fan S. Noli" (UNIKO), rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë (FE), (evidenca 2.2, kreu VI, nenin 42), si dhe rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë" (evidenca 2.5, pika 3), u konstatua se programet e studimit të UNIKO-s janë në përputhje me interesat kombëtare. Kjo vjen si rezultat i natyrës së tyre specifike shkencore dhe përmbajtjes akademike të përshtatur me nevojat e tregut.</p> <p>Në këtë kontekst, edhe programi Master i Shkencave në "Financë" synon të përgatisë profesionistë të aftë në fushën e tregjeve financiare. Programet e studimit në Universitetin "Fan S. Noli" mbështeten në kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, duke garantuar cilësi dhe përputhshmëri me standardet akademike.</p> <p><i>Evidenca: 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Evidenca: 2.2 Rregullorja e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca: 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit "Master i Shkencave" në "Financë"</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Sipas evidencës 1.1 dhe Statutit të Universitetit "Fan S. Noli" (UNIKO), (neni 2, 3), është përcaktuar se misioni i UNIKO-së përfshin, ndër të tjera, zhvillimin e dijeve përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Në këtë kuadër, misioni i Programit të Studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Financë", është përgatitja e specialistëve me njohuri bashkëkohore dhe aftësi profesionale në këtë fushë.</p> <p><i>Evidenca: 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli"</i> <i>Evidenca: 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Evidenca: 2.2 Rregullorja e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca: 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit "Master i Shkencave" në "Financë"</i></p>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje	<p>Programi i Studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Financë", hartohet dhe ofrohet në zbatim të strategjisë për zhvillim të Fakultetit të Ekonomisë, si dhe në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Fan S. Noli" (UNIKO). Programi është i përshtatur me fushat dhe drejtimet akademike të institucionit, duke siguruar koherencë me standardet akademike dhe nevojat e tregut të punës.</p>

me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	<i>Evidenca:1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli"</i> <i>Evidenca: 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Evidenca:2.2 Rregullorja e Brendshme e Fakultetit te Ekonomisë</i> <i>Evidenca:2.4 Plani Strategjik për Zhvillimin e FE (2022-2027)</i> <i>Evidenca:2.5Rregullorja e Programit të Studimit "Master i Shkencave" në "Financë"</i>		
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i Studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Financë", është hartuar në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit, interesat kombëtare dhe prirjet globale të zhvillimit. Ky program ka për qëllim të përgatisë profesionistë të kualifikuar në fushën e financave, duke ofruar njohuri dhe aftësi që përputhen me tendencat dhe kërkesat aktuale të tregut. <i>Evidenca:1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli"</i> <i>Evidenca: 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Evidenca:2.2 Rregullorja e Brendshme e Fakultetit te Ekonomisë</i> <i>Evidenca:2.4 Plani Strategjik për Zhvillimin e FE (2022-2027)</i> <i>Evidenca:2.5Rregullorja e Programit të Studimit "Master i Shkencave" në "Financë"</i>		
Konkluzione	<i>GVJ, duke u mbështetur në dokumentacionin e ofruar nga institucioni dhe në vizitën e realizuar në institucion, konkludon se programi i studimit Master i Shkencave në "Financë" është në përputhje me misionin dhe qëllimin e veprimtarisë së UNIKO-së, duke ruajtur dhe promovuar interesat dhe vlerat kombëtare.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Organizimi i UNIKO dhe struktura e tij hierarkike janë ndërtuar në mënyrë të tillë që të sigurojnë përmbushjen e misionit dhe objektivave të institucionit, si dhe të programit të studimit "Financë" në kuadër të Masterit Shkencor. Ky organizim mbështetet në përvojën, kapacitetet dhe burimet njerëzore të nevojshme për realizimin me sukses të këtij misioni. Fakulteti i Ekonomisë (FE) dhe Departamenti i Financë-Kontabilitetit (DFK), si njësi kryesore që mbulon këtë program, ofrojnë ekspertizën dhe kualifikimet e duhura akademike për të garantuar zhvillimin cilësor të tij. Sipas të dhënave të pasqyruara në tabelën 1 mbi stafin akademik të Fakultetit të Ekonomisë, rezulton se kjo njësi përbëhet nga tre departamente, me një numër të qëndrueshëm staf akademik përgjatë tre viteve të fundit: 31 pedagogë me angazhim të plotë (PAE), 2 pedagogë me angazhim të pjesshëm (PAK) dhe 2 persona staf ndihmës akademik. Kjo tregon se institucioni zotëron

	<p>përvojën dhe kapacitetet e nevojshme për ofrimin e një programi cilësor në fushën e Financës.</p> <p>Në veçanti, Departamenti i Financë-Kontabilitetit (DFK), si njësi bazë për programin e Masterit Shkencor në "Financë", ka ruajtur një numër të qëndrueshëm të stafit akademik gjatë tre viteve të fundit akademike, përkatësisht: 13 pedagogë me angazhim të plotë (PAE), 1 pedagog me angazhim të pjesshëm (PAK) dhe 1 personel ndihmës akademik, sipas të dhënave të pasqyruara në tabelat 1 dhe 2 të RVB.</p> <p><i>Evidenca 4.1 Tabela Permbledhese Per Programin E Studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Sipas evidencës 2.2 të rregullores së Fakultetit të Ekonomisë (FE) dhe evidencës 2.3 të rregullores së Departamentit të Financë-Kontabilitetit (DFK), konstatohet se ky departament ofron programe studimi në fushën e financës, si në nivelin profesional ashtu edhe në atë shkencor. Programet akademike organizohen në dy nivele: Ciklin e Parë dhe Ciklin e Dytë, duke synuar të ofrojnë njohuri të krahasueshme me ato të institucioneve të ngjashme universitare jashtë vendit.</p> <p>Bazuar në raportin e vlerësimit të brendshëm (RVB), programi i Masterit Shkencor në "Financë" është i klasifikuar në nivelin 7 të Kornizës Europiane dhe Shqiptare të Kualifikimeve.</p> <p><i>Evidenca:1.1 Statuti I Universitetit 'Fan S. Noli'</i> <i>Evidenca:2.2 Rregullorja e Brendshme e Fakultetit te Ekonomisë</i> <i>Evidenca 2.3 Rregullorja e Departamentit Financë-Kontabilitet</i> <i>Evidenca:2.5 Rregullorja e Programit të Studimit "Master i Shkencave" në "Financë"</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Analiza e CV-ve të stafit akademik efektiv dhe atij me kontratë për këtë program dëshmon një përputhje të lartë midis kualifikimeve akademike dhe lëndëve të mësimdhëna, duke siguruar një standard të lartë cilësie në procesin akademik.</p> <p>Në të njëjtën kohë, fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të Masterit Shkencor në "Financë" është plotësisht e harmonizuar me drejtimin akademik dhe kërkimor të njësisë kryesore dhe asaj bazë, e cila mban përgjegjësinë për zhvillimin dhe implementimin e tij. Kjo përputhje siguron një zhvillim të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt standardeve akademike dhe profesionale bashkëkohore.</p> <p><i>Evidenca:2.2 Rregullorja e Brendshme e Fakultetit te Ekonomisë</i> <i>Evidenca 2.3 Rregullorja e Departamentit Financë-Kontabilitet</i> <i>Evidenca:2.5 Rregullorja e Programit të Studimit "Master i Shkencave" në "Financë"</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p><i>Ky kriter nuk aplikohet</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime</p>	<p>Referuar të dhënave të RVB, pranë UNIKO operon Qendra e Inovacionit (INNOV8), e themeluar në vitin 2018 si pjesë e projektit</p>

<p>profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>“Innovation Eco System in the CBC area (CBC INNOV8)”. Po ashtu, në strukturën e Fakultetit të Ekonomisë funksionon Qendra SMART e Inovacionit, e krijuar në vitin 2022 në kuadër të projektit "SMART Innovation Centres".</p> <p>Në këto qendra janë zhvilluar trajnime të ndryshme, të cilat kanë pasur në fokus mbështetjen dhe promovimin e modeleve inovative, si dhe menaxhimin e SME-ve dhe Start-up-eve. Në këto aktivitete kanë marrë pjesë studentë, të sapodiplomuar, përfaqësues të biznesit dhe institucioneve lokale.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me përfaqësues të GVB, P/Dep., dhe Qendrës së Alumnit dhe Karrierës (QAK), u konfirmua se kjo e fundit ofron këshillim profesional, seminare dhe informacion për orientimin e studentëve drejt tregut të punës pas përfundimit të studimeve.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Evidenca 2.2 Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Evidenca 2.3 Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i></p> <p>https://unkorce.edu.al/nisma-per-mbeshtetjen-e-start-up-ve-permes-financimeve-direkte-nga-palet-te-treat-u-prezantua-per-studente-te-uniko-ne-kuader-te-dites-se-sipermarrjes/.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ, duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni dhe në gjetjet e vizitës së realizuar, vlerëson se programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe njësisë bazë përgjegjëse për zhvillimin e tij. Sipas të dhënave të RVB, institucioni ofron trajnime profesionale të avancuara për studentët, në bashkëpunim me punëdhënësit. GVJ konfirmon se ky standard është përmbushur plotësisht.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi I.3 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e UNIKO-së (Kreu IV, nenet 25 dhe 26; Kreu V, nenet 29,36 dhe 37) dhe Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë (Kreu II, nenet 5, 6, 7, 13 dhe 14; Kreu III, nenet 22 dhe 23), si dhe në konkluzionet e raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), konstatohet se institucioni promovon dhe inkurajon bashkëpunimin e ngushtë midis</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

10

<p>brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>personelit akademik, joakademik, administrativ dhe studentëve. Këto njësi bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme për procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke siguruar një koordinim efektiv mes të gjitha hallkave dhe strukturave përgjegjëse, drejtuese dhe mbështetëse. Njësia kryesore dhe njësia bazë realizojnë çdo vit analizën e veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe shkencore, duke e dokumentuar atë edhe në DVV.</p> <p><i>Evidenca: 1.1 Statuti I Universitetit "Fan S. Noli"</i></p> <p><i>Evidenca: 1.2 Rregullorja e UNIKO</i></p> <p><i>Evidenca: 2.2 Rregullorja e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>Evidenca: 2.3 Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024</i></p> <p><i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Sipas dokumentacionit shoqërues (Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit), GVJ konstatoi se UNIKO ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit për të mbështetur realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe përgatitjen profesionale të studentëve.</p> <p>UNIKO dhe Fakulteti i Ekonomisë (FE) kanë një bashkëpunim të gjerë me institucione publike, biznese, sipërmarrje dhe aktorë të tjerë në vend, duke mundësuar shkëmbimin e eksperiencave dhe ekspertizës për përmirësimin e procesit mësimor dhe arritjen e objektivave të programeve të studimit. Ky bashkëpunim u ofron gjithashtu studentëve mundësinë për të zhvilluar praktika profesionale.</p> <p>Në dokumentacionin shoqërues të DVV janë të listuara marrëveshjet e bashkëpunimit të UNIKO-së me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, si dhe me institucionet partnere. Gjatë vizitës së GVJ në institucion, këto marrëveshje u konfirmuan si pjesë e angazhimit të universitetit për bashkëpunim akademik dhe profesional.</p> <p><i>Evidenca 3.25 Marrëveshje Institucionale.</i></p> <p><i>Evidenca 3.26 Marrëveshjet e bashkëpunimi midis Departamentit të Financë-Kontabilitetit dhe biznesit privat</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të</p>	<p>Për të siguruar realizimin e praktikave profesionale dhe përmbushjen e objektivave të programit mësimor, UNIKO dhe Fakulteti i Ekonomisë kanë një bashkëpunim të gjerë me institucione publike, biznese private, sipërmarrje, institucione financiare, banka dhe kompani sigurimi. Këto partneritete u mundësojnë studentëve të kryejnë praktikat profesionale të nevojshme për përgatitjen e tyre akademike dhe profesionale.</p> <p>Gjithashtu, UNIKO ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, duke lehtësuar realizimin e projekteve kërkimore-shkencore si dhe mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financë-Kontabilitetit kanë formalizuar bashkëpunime me aktorë dhe biznese vendase për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, zhvillimin e kërkimit shkencor, përmirësimin e kurrikulës së programeve të studimit dhe ofrimin e mundësive për praktika profesionale për studentët.</p>

personelit akademikt dhe studentëve.	<i>Evidenca 3.25 Marrëveshje Institucionale. Evidenca 3.26 Marrëveshjet e bashkëpunimi midis Departamentit të Financë-Kontabilitetit dhe biznesit privat</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Njësia përgjegjëse për programin Master Shkencor në “Financë” mban evidenca dhe analizon përfitimet e studentëve pas diplomimit, duke vlerësuar ndikimin e programit në punësimin dhe zhvillimin e tyre profesional. Në mënyrë periodike, harton raporte analitike për të vlerësuar efektivitetin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me palët e treta dhe ndikimin e tyre në përmirësimin e programit dhe realizimin e objektivave akademike e profesionale. Këto analiza ndihmojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programit dhe forcimin e lidhjeve me industrinë, duke rritur mundësitë e punësimit për të diplomuarit. <i>Evidenca: 2.4 Plani Strategjik për Zhvillimin e FE (2022-2027) Evidenca 3.26 Marrëveshjet e bashkëpunimi midis Departamentit të Financë-Kontabilitetit dhe biznesit privat Evidenca 3.6 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programit të studimit Evidenca 3.21 Tabela e marrëveshjeve institucionale UNIKO</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni dhe vizitën e realizuar, konkludon se njësia përgjegjëse për programin MSH në “Financë” mban evidenca mbi përfitimet e studentëve pas diplomimit dhe analizon ndikimin e programit në punësimin e tyre. Përmes raporteve analitike periodike, vlerësohet efektiviteti i marrëveshjeve të bashkëpunimit me palët e treta, duke siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të programit dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rregulloreve të UNIKO, njësisë kryesore dhe njësisë bazë, si dhe rregullores së programit të studimit, kurrikulës dhe planit mësimor, GVJ konstaton se Programi i Studimit Master Shkencor në “Financë” është i strukturuar në lëndë/module të detyrueshme dhe me zgjedhje. Këto njësi mësimore janë të ndara sipas

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

12

përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

veprimtarive formuese (A-E) dhe vlerësohen me kredite në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sipas rregullores së programit të studimit (nenet 7-9), ky program ka një kohëzgjatje prej 2 (dy) vite akademike, të organizuar në 4 semestra, dhe përmban gjithsej 120 kredite (ECTS), duke respektuar kërkesat e ligjit Nr. 80/2015 për arsimin e lartë.

GVJ konstaton se disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në programin e studimit janë të organizuara në 5 kategori, nga A në E, në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar me VKM nr. 879/2019 dhe VKM nr. 185/2021.

Në hartimin e kurrikulës dhe planit mësimor të programit të studimit, në kategoritë (A, C dhe E), *nuk është ruajtur raporti i shpërndarjes së krediteve sipas disiplinave përkatëse.*

Sipas të dhënave të kurrikulës dhe planit mësimor, ky program studimi përfshin 18 module, praktikën profesionale dhe temën e diplomës. Programi është hartuar në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 41 të ndryshuar (shtojca 1, VKM 185/2021), dhe kategorizimi i lëndëve është si më poshtë:

Kategoria	Komponenti mësimor	Kërkesat ligjore: Master Shkencor	MSH_ Financë Kredite
A	LËNDË BAZË – Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (1 lëndë)	15–20% (kredite)	6 (kredite) 5%
B	LËNDË KARAKTERIZUESE – Përgatitje për disiplinën shkencore (11 lëndë)	50–55% (kredite)	64 (kredite) 53%
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE – Nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (4 lëndë)	12–15% (kredite)	24 (kredite) 20%
D	LËNDË PLOTËSUESE – (Gjuhë e huaj dhe praktika profesionale) (2 lëndë)	10-15 % (kredite)	12 (kredite) 10%
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3-5% (kredite)	14 (kredite) 12%
	Tezë Diplome		
*	Totali		120 Kredite

GVJ rekomandon që të ruhet raporti i shpërndarjes së krediteve për kategoritë (A, C dhe E) në përputhje me disiplinat përkatëse.

	<p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Evidenca 2.2 Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Evidenca 2.3 Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i> <i>Evidenca 2.7 Plani Mësimor i Programit Të Studimit.</i> <i>Evidenca 3.30 Kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave në Financë 2022-2023; 2023-2024; 2024-2025</i> <i>Evidenca 4.1 Tabela Permbledhese Per Programin E Studimit (tabela nr 9)</i></p>
<p>Kriteri 2.Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit të studimit, Master Shkencor në "Financë", objektivat formues të programit përfshijnë, ndër të tjera, pajisjen e studentëve me njohuri teorike dhe praktike, zhvillimin e kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, si dhe përgatitjen e specialistëve të aftë me njohuri të thelluara në fushën e shërbimeve financiare.</p> <p><i>Gjithashtu GVJ Sugjeron:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>Rikategorizimi i lëndëve:</u> Lënda <i>Excel për Menaxherët</i>, që është aktualisht e kategorizuar si lëndë për përgatitjen e disiplinës shkencore (kategoria B), duhet të zhvendoset në kategorinë D, pasi lidhet me njohuri informatike dhe praktika profesionale. Po ashtu, <i>Menaxhimi i Financave</i> nuk duhet të jetë lëndë me zgjedhje në kategorinë C, por duhet të spostohet në kategorinë B për t'iu përkushtuar përgatitjes për disiplinën shkencore. • <u>Rishikimi i planit mësimor:</u> Lënda <i>Metodologjia e Kërkimit</i> duhet të transferohet në semestrin e parë për të pasur një ndikim më të drejtpërdrejtë në aftësitë kërkimore të studentëve. Gjithashtu, lënda <i>Sistemi Monetar Evropian</i> duhet të përmirësohet ose të zëvendësohet me një lëndë më teknike që i përgjigjet më mirë nevojave të studentëve në fushën e financave. • <u>Shtimi i lëndëve të reja:</u> Programi mund të përmirësohet duke shtuar lëndë si <i>Drejtimit Portofoli</i>, <i>Menaxhim Strategjik i Avancuar</i>, <i>Tregjet dhe Institucionet Financiare dhe Drejtimit Risku</i>. • <u>Përditësimi i literaturës:</u> Disa lëndë ende përdorin literaturë të vjetër, përfshirë referenca që datojnë mbi 10 vjet. Kërkohej që literatura të përditësohet me burime më të reja dhe të përshtatshme për zhvillimet e fundit në fushën e financave. • <u>Përshtatja e syllabuseve me formatin zyrtar:</u> Asnjë nga syllabuset e programit të Masterit Shkencor në "Financë" nuk është hartuar sipas formatit të shtojcës nr. 2 të VKM nr. 41, datë 24.1.2018. Kërkohej që syllabuset të përputhen plotësisht me këtë standard për të siguruar cilësinë dhe harmonizimin e dokumentacionit të programit.

	<p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Evidenca 2.2 Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Evidenca 2.3 Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i> <i>Evidenca 2.7 Plani Mësimor i Programit Të Studimit.</i> <i>Evidenca 3.30 Kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave në Financë 2022-2023; 2023-2024; 2024-2025</i> <i>Evidenca 4.1 Tabela Permbledhese Per Programin E Studimit (tabela nr 9)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Sipas dokumentacionit shoqërues të RVB, konstatohet se në kurrikulën dhe planin mësimor të programit të studimit është specifikuar qartë se realizimi i praktikës profesionale, si lëndë e kategorisë D, vlerësohet me 6 kredite (në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41 të ndryshuar me VKM nr. 879) dhe realizohet në semestrin e dytë të studimeve. Detyrimet përmbyllëse për këtë program studimi, që përfshijnë përgatitjen dhe mbrojtjen e temës së diplomës, janë të përfshira në kategorinë E dhe vlerësohen me 14 kredite.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Evidenca 2.2 Rregullore e Brendshme e FE_UNIKO_2023;</i> <i>Evidenca 2.3 Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet_FE_2024;</i> <i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i> <i>Evidenca 2.7 Plani Mësimor i Programit Të Studimit.</i> <i>Evidenca 3.30 Kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave në Financë 2022-2023; 2023-2024; 2024-2025</i> <i>Evidenca 4.1 Tabela Permbledhese Per Programin E Studimit (tabela nr 9).</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p><i>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim</p>	<p><i>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi</i></p>

<p>të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Bazuar në Statutin e UNIKO, kapitujt VI, VII dhe X, si dhe në vlerësimin pas vizitës në institucion, GVJ ka konstatuar se organizimi i studimeve, procesi i pranimit të studentëve dhe financimi i aktiviteteve akademike dhe kërkimore zhvillohen në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe kuadrin ligjor të përcaktuar nga Ministria e Arsimit. GVJ konstaton se ky program është hapur në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015 dhe se UNIKO, nuk ka status të veçantë.</p> <p><i>Evidenca: 1.1 Statuti I Universitetit ‘Fan S. Noli’</i></p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Duke u mbështetur në evidencën 4.1, tabela 9, 10, 11, 12 të planeve mësimore, si dhe në evidencat 2.7 dhe 3.30 u vërejt se përmbajtja e këtyre planeve është rreth 70% e ngjashme në nivel dhe kanë të njëjtën emërtesë.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë në UNIKO, përmes Departamentit të Financë-Kontabilitetit, ofron tre programe studimi në ciklin e dytë: Master Profesional “Bankë dhe Sigurime”, Master Profesional “Financë-Kontabilitet”, dhe Master Shkencor në “Financë”, të cilat kanë një përmbajtje përkatëse të përbashkët prej rreth 70%.</p> <p><i>Evidenca 4.1 Tabela Permbledhese Per Programin E Studimit</i> <i>Evidenca 2.7 Plani Mësimor i Programit Të Studimit.</i> <i>Evidenca 3.30 Kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave</i></p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Sipas analizës së rregullore së programit të studimit, GVJ konfirmon se Programi i Studimit Master Shkencor në “Financë” është një program studimi i ciklit të dytë, sipas nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (shtojca 1, VKM 185/2021). Ky program ka një kohëzgjatje normale prej dy vitesh akademike me kohë të plotë, i organizuar në 4 semestra, dhe ka në total 120 kredite (ECTS), në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015.</p> <p>Sipas dokumentacionit shoqërues (aneksit për kodifikimin e programeve të studimit) dhe të dhënave të RVB, programi i studimit Master Shkencor në “Financë” është kodifikuar me kodin “72MSH0412S”, në përputhje me kërkesat ligjore të VKM 310/2022.</p> <p><i>Evidenca 2.14 Propozim për kodifikimin e programeve të studimit</i> <i>Evidenca 2.7 Plani Mësimor i Programit Të Studimit.</i> <i>Evidenca 2.2 Rregullore e Brendshme e FE UNIKO_2023;</i> <i>Evidenca 2.3 Rregullorja e Dep. Finance-Kontabilitet FE_2024;</i></p>

Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit programi Master i Shkencave në “Financë” nuk është program i përbashkët midis IAL-ve, jashtë apo brenda vendit por realizohet nga UNIKO. <i>Evidenca: 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit “Master i Shkencave” në “Financë”</i>			
Konkluzione	GVJ, duke u mbështetur në dokumentacionin e ofruar nga institucioni dhe vizitën e realizuar, konkludon se programi i studimit MSH në “Financë” është organizuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si në strukturë ashtu edhe në përmbajtje. GVJ rekomandon që në hartimin e kurrikulës dhe planit mësimor të programit të studimit, në kategoritë (A, C dhe E), të ruhet raporti i shpërndarjes së krediteve sipas disiplinave përkatëse referuar edhe në kriterin 1. Gjithashtu, GVJ sugjeron që, duke pasur parasysh zhvillimet e tregut financiar gjatë viteve të fundit, të realizohen përmirësime në program, të paktën në një masë prej 20% të krediteve të programit, duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në kriterin 2.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Master Shkencor në “Financë” është Fakulteti i Ekonomisë (FE). Ky fakultet përbëhet nga tre departamente: 1) Departamenti i Financë-Kontabilitetit; 2) Departamenti i Menaxhimit; 3) Departamenti i Marketing-Turizëm Departamenti i Financës-Kontabilitetit (DFK) është njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Shkencor në “Financë”. Sipas dokumentacionit shoqërues, për vitin akademik 2024-2025, ky departament ofron gjithsej 5 (pesë) programe studimi: <ul style="list-style-type: none"> • 2 (dy) programe studimi në ciklin e parë të studimeve (Bachelor) • 1 (një) program në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave • 2 (dy) programe në ciklin e dytë Master Profesional Për vitin akademik 2024-2025, DFK ka në përbërjen e tij 14 pedagogë (PAE dhe PAK), nga të cilët, 1 Prof Dr., 6 janë me titullin Profesor i Asociuar, 7 janë me gradën shkencore “Doktor”.

Të dhënat për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik (PAE dhe PAK) për njësinë bazë përgjegjëse (DFK) dhe për programin e studimit Master i Shkencave në "Financë" janë paraqitur më poshtë, sipas viteve akademike:

Kualifikimi i stafit akademik për Programin e Studimit: "MSH Financë"	2024-2025		2023-2024		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	-	1	-	1	-
Prof. Asoc.	6	-	6	-	5	-
Dr./PhD.	7	-	7	-	8	-
MSc.	-	-	-	-	-	-
Totali	14	-	14	-	14	-

Sa i përket kualifikimeve të personelit akademik gjatë tre viteve akademike, 100% e stafit akademik (PAE dhe PAK) disponojnë gradë shkencore dhe tituj akademik.

Të dhënat për raportet numerike mes personelit akademik efektiv (PAE) dhe personelit akademik me kontratë (PAK) janë si vijon:

- Për vitin akademik 2024-2025, raporti është 14/0, pra 100% me 0%.
- Për vitin akademik 2023-2024, raporti është 14/0, pra 100% me 0%.
- Për vitin akademik 2022-2023, raporti është 14/0, pra 100% me 0%.

Evidenca 1.1 Statuti i UNIKO

Evidenca 1.2 Rregullorja e UNIKO

Evidenca 2.3 Rregullorja e Departamentit Financë-Kontabilitet

Evidenca 2.2 Rregullorja e brendshme të Fakultetit të Ekonomisë

Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"

Evidenca 4.1 Tabela Permbledhese per Programin e Studimit

Evidenca 4.2 Tabela e ngarkesës së personelit akademik 2022-23; 2023-24 të angazhuar në programin e studimit

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (Tabelat përmbledhëse 1,2), konstaton se Departamenti i Financë-Kontabilitetit, si njësi bazë, ka në përbërjen e tij edhe 1 (një) anëtar si personel ndihmës akademik.

Personeli ndihmës akademik ka rol në mbështetjen dhe ndihmën e stafit akademik për realizimin e objektivave të veprimtarive të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe koordinimin e aspekteve administrative në nivel departamenti.

Evidenca 2.3 Rregullorja e Departamentit Financë-Kontabilitet

Evidenca 2.2 Rregullorja e brendshme të Fakultetit të Ekonomisë

	<p><i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i> <i>Evidenca 4.1 Tabela Permbledhese per Programin e Studimit</i> <i>Evidenca 4.2 Tabela e ngarkesës së personelit akademik 2022-23; 2023-24 të angazhuar në programin e studimit</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqëruar (rregulloreve institucionale dhe rregullores së njësisë bazë, neni 9), si dhe gjatë takimit me GVB dhe P/Dep, u konfirmua se Departamenti i Financë-Kontabilitetit ka emëruar një personel akademik për të mbajtur rolin e koordinatorit të programit të studimit. Ky koordinator është përgjegjës për monitorimin dhe zhvillimin e procesit mësimor dhe praktikave profesionale, duke siguruar që ato të jenë në përputhje me objektivat e programit të studimit. Detyrat e koordinatorit janë përcaktuar në rregulloren e njësisë bazë. Koordinatori bashkëpunon ngushtë me strukturat e tjera përgjegjëse, grupet mësimore dhe stafin akademik për të siguruar përparimin e suksesshëm të procesit mësimor. Ai raporton rregullisht dhe ka një lidhje të drejtpërdrejtë me përgjegjësin e Departamentit.</p> <p><i>Evidenca 2.3 Rregullorja e Departamentit Financë-Kontabilitet</i> <i>Evidenca 2.2 Rregullorja e brendshme të Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i> <i>Evidenca 4.1 Tabela Permbledhese per Programin e Studimit</i> <i>Evidenca 4.2 Tabela e ngarkesës së personelit akademik 2022-23; 2023-24 të angazhuar në programin e studimit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni dhe vizitën e zhvilluar në ambientet e tij, konkludon se njësia kryesore FE dhe njësia bazë DFK për programin e studimit MSH në "Financë" përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë. Kjo vlen si për njësinë kryesore ashtu edhe për atë bazë, veçanërisht në lidhje me numrin e personelit akademik me kohë të plotë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.3 Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, konstaton se informacionet e rëndësishme lidhur me programin e studimit Master Shkencor në "Financë" janë të disponueshme nga Fakulteti i Ekonomisë (njësia kryesore) dhe Departamenti i Financës-Kontabilitetit (DFK) (njësia bazë). Këto informacione përfshijnë rregulloret përkatëse, planin mësimor të programit dhe elementë të tjerë kyç dhe janë të aksesueshme publikisht.</p>

	<p>GVJ gjithashtu konfirmon se përmbajtja e programit të studimit, plani mësimor dhe informacionet e tjera të lidhura janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të institucionit dhe mund të aksesohen lirshëm.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UNIKO_2023</i> <i>Evidenca 2.3 Rregullorja e Departamentit Financë-Kontabilitet</i> <i>Evidenca 2.2 Rregullorja e brendshme të Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i> <i>Evidenca 3.30 Kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave në Financë</i> <i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i> <i>Evidenca 4.1 Tabela Permbledhese per Programin e Studimit</i> <i>Evidenca 3.26 Programet e studimit te ofruara nga Departamenti Finance-Kontabilitet;</i> https://unkorce.edu.al/fakulteti-i-ekonomise-3/ https://unkorce.edu.al/departamenti-i-finance-kontabilitet/ https://unkorce.edu.al/archive/unkorce_programet/programet.php?</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Nga analiza e programit të studimit, konstatohet se ai ofron të gjithë informacionin e nevojshëm, duke përfshirë elementët kryesorë si ngarkesën mësimore, orët e zhvilluara në auditor dhe jashtë tij, mënyrën e ndjekjes së programit (me kohë të plotë) dhe procesin e vlerësimit të dijeve.</p> <p>Programi mbështetet nga rregulloret përkatëse në nivel institucioni, fakulteti, departamenti dhe vetë programit të studimit.</p> <p>Plani mësimor, përbën dokumentacionin kryesor dhe përfshin elementët e mëposhtëm në përputhje me kriteret e VKM Nr.41, datë 24.01.2018, ndryshuar me VKM nr.879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr. 185, datë 25.3.2021:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emërtimin për secilin modul të këtij programi studimi, të grupuara dhe të renditura sipas semestrave përkatës; 2. Numrin e krediteve për çdo modul; 3. Orët në total për secilin modul dhe raportin e orëve (leksione/seminare); 4. Detyrimet për secilin modul (leksione; seminare, ushtrime, detyra kursi, etj.); 5. Numrin e orëve për punë individuale. <p>Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike dhe përfshin (leksione, seminare, ushtrime, detyra kursi, praktikën profesionale dhe temën e diplomës).</p> <p>Procedurat e vlerësimit të studentëve janë të përshkruara në syllabuset e secilës lëndë dhe janë në përputhje me Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, Rregulloren e Departamentit të Financës-Kontabilitetit dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Vlerësimi përfshin disa komponentë: provimet e ndërmjetëm, angazhimin në seminare, realizimin e projekteve/detyra kursi dhe provimin përfundimtar.</p>

	<p>Për programin e studimit MSH në "Financë", sipas planit mësimor, semestri i dytë parashikon realizimin e praktikës profesionale dhe përgatitjen e temës së diplomës.</p> <p><i>Evidenca 2.3 Rregullorja e Departamentit Financë-Kontabilitet</i> <i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i> <i>Evidenca 2.7 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.26 Programet e studimit të ofruara nga Departamenti Finance-Kontabilitet</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ vëren se kriteret e përgjithshme për pranimin në programin Master Profesional në "Bankë dhe Sigurime", si dhe për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve, janë përcaktuara në dokumentet rregullatore të institucionit, duke përfshirë Statutin e UNIKO (neni 57), Rregulloren e UNIKO (neni 48), Rregulloren e brendshme të Fakultetit të Ekonomisë (neni 52), Rregulloren e Njesisë Bazë (neni 24) dhe Rregulloren e programit të studimit (neni 8).</p> <p>Pranimi i studentëve në këtë program realizohet në përputhje me kriteret ligjore dhe udhëzimet përkatëse të MASR. Kushti bazë për regjistrim është përfundimi i studimeve të ciklit të parë, ndërsa kriteret shtesë për pranimin në ciklin e dytë përcaktohen dhe shpallen çdo vit nga institucioni, duke iu dërguar për miratim MAS. Rregulloret e UNIKO, njësisë kryesore dhe njësisë bazë përcaktojnë gjithashtu kriteret për njohjen e krediteve, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Informacionet e detajuara mbi kriteret e pranimit dhe transferimeve publikohen edhe në faqen zyrtare të UNIKO.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIKO_2022;</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullore e UNIKO_2023;</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Evidenca 2.3 Rregullorja e Departamentit Financë-Kontabilitet</i> <i>Evidenca 2.2 Rregullorja e brendshme të Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca 2.22 Kriteret e pranimit në programin e studimit Master i Shkencave në Financë</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit, rezulton se ai përmban të gjithë elementët përbërës teorikë dhe praktikë të nevojshëm për një program të nivelit Master Shkencor. Analizimi i syllabuseve tregon se ato janë hartuar në gjuhën shqipe dhe përmbushin të gjitha kërkesat e përcaktuara në Vendimin e KM Nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, duke përfshirë elementët si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emërtimi i lëndës/modulit • Viti/semestri kur zhvillohet lënda • Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën • Pozita e lëndës në formimin e përgjithshëm të studentit • Njohuritë paraprake që kërkohen për përvetësimin e lëndës • Aftësitë dhe njohuritë që do t'u japë studentëve kjo lëndë • Temat që do të trajtohen në formimin teorik dhe praktik • Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë tij, si dhe në ECTS

	<ul style="list-style-type: none"> • Format dhe metodat e mësimdhënies, si dhe raportet midis tyre • Format e vlerësimit të studentëve • Detyrimet e studentëve për lëndën • Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse <p>GVJ vlerësoi cilësinë e syllabuseve të programit të studimit të prezantuar gjatë këtij vlerësimi. Hartimi i syllabuseve përfshin të gjitha elementët e nevojshëm dhe plotëson kriteret përkatëse. Format e mësimdhënies përfshijnë vlerësimin periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyrat e kursit, provimet e ndërmjetme dhe provimin final. Megjithatë, formati i syllabuseve nuk është i njëjtë me atë të shtojcës nr. 2 të Vendimit të KM Nr. 41, datë 24.01.2018.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Evidenca 2.2 Rregullorja e brendshme të Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca 2.7 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.12 Model Programi Lëndor</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik që mbulon këtë program me stafin e DFK si dhe me Përgjegjës të DFK, u evidentua se programi rishikohet dhe përshtatet në mënyrë periodike, kryesisht në fillim të vitit, duke respektuar lirinë akademike dhe duke përfshirë informacione të reja dhe njohuri të përditësuara. Plani mësimor përditësohet çdo vit, bazuar në propozimet që vijnë nga departamenti, pas një takimi të organizuar në fund të vitit akademik. Propozimet e argumentuara përmbushin detyrimin që rrjedh nga Rregullorja e Brendshme e FE, Kreu II, Neni 6, Pika 2. Planet mësimore miratohen nga Senati Akademik. Studentëve iu bëhet i njohur plani mësimor që në fillim të vitit akademik.</p> <p><i>Evidenca 2.2 Rregullorja e brendshme të Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i> <i>Evidenca 2.7 Plani mësimor i programit të studimit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni dhe vizitën e realizuar në institucion, konkludon se programi i studimit MSH në "Financë" është i detajuar dhe përmban të gjithë elementët e nevojshëm, duke qenë i strukturuar dhe organizuar për të arritur objektivat formues të tij. Përmbajtja e lëndëve dhe moduleve të programit është e plotë dhe përmban të gjithë elementët përkatës. Megjithatë, GVJ sugjeron realizimin e përmirësimeve në program, duke u mbështetur në rekomandimet e dhëna më parë në Standardin II.1, Kriteri 2 si dhe ndryshohet formati i syllabuseve sipas shtojcës nr. 2 të Vendimit të KM Nr. 41, datë 24.01.2018.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Referuar Rregullores së programit të studimit të Masterit Shkencor në "Financë", si dhe Rregullores së FE u konstatuan disa të dhëna të rëndësishme. Në këtë program, organizimi i lëndëve është realizuar në përputhje me LAL 80/2015. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve në programin e Masterit Shkencor në "Financë" mundësojnë thellimin e njohurive dhe aftësive të studentëve dhe ndihmojnë në rritjen e mundësive për punësim. Gjithashtu, sipas evidencës 2.10, bashkëpunimet që UNIKO ka me aktorët e tregut të punës kanë rezultuar gjithashtu në një përqindje të lartë punësimi për studentët e diplomuar nga ky program.</p> <p><i>Evidenca 2.3 Rregullorja e Departamentit Financë-Kontabilitet</i> <i>Evidenca 2.2 Rregullorja e brendshme të Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca 2.10 Marrëveshje Bashkëpunimi Në Mbështetje Të Praktikave Profesionale</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Pas analizës së programit të studimit, vërehet se ai përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, përfshirë elementët kyç si ngarkesën mësimore, orët e zhvilluara në auditor dhe jashtë tij, mënyrën e ndjekjes së programit (me kohë të plotë) dhe metodologjinë e vlerësimit të dijeve. Ky program mbështetet nga rregulloret përkatëse të hartuara në nivel institucioni, fakulteti, departamenti dhe programi. Për më tepër, rregullore të veçanta përcaktojnë modalitetet dhe kriteret e regjistrimit të studentëve potencialë, si dhe rregullojnë procedurat për transferimet e studimeve nga institucione të tjera ose brenda programit.</p> <p><i>Evidenca 2.3 Rregullorja e Departamentit Financë-Kontabilitet</i> <i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i> <i>Evidenca 2.7 Plani mësimor i programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Bazuar në dosjen e plotë të programit të studimit të MSH në "Financë", u konstatua se për krijimin e këtij programi dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të strukturës kurrikulare janë përdorur eksperiencat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare. Programi është zhvilluar duke u bazuar në praktikat bashkëkohore evropiane dhe duke marrë parasysh kërkesat dhe nevojat e tregut të punës. Nga analiza e strukturës së programit dhe lëndëve të përfshira, si dhe nga raportet teorike dhe praktike, ky program është në përputhje të plotë me fushën e zgjedhur, atë financiare.</p> <p><i>Evidenca 2.2 Rregullorja e brendshme të Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca 2.3 Rregullorja e Departamentit Financë-Kontabilitet</i> <i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i> <i>Evidenca 2.7 Plani mësimor i programit të studimit</i></p>

Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.

Përmbajtja e programit të studimit siguron një balancë mes njohurive teorike dhe atyre praktike.

Duke shqyrtuar syllabuset e lëndëve kryesore të programit, vërehet se një pjesë e temave i referohen rasteve studimore duke synuar të përcillen tek studentët formimi teorik dhe praktik i nevojshëm për ta në funksion të punësimit të tyre. Përmbajtja e këtyre lëndëve është e ngjashme me atë të programeve të ofruara në universitete të tjera ndërkombëtare, duke mundësuar ekuivalentimin në rast të transferimeve të studimeve.

Viti i Parë		
Nr	Emërtimi i vep. formuese	Ngarkesa/orë
1	Leksione	375 orë
2	Seminare,ushtrime,detyra kursi, etj.	225 orë
3	Praktika profesionale	-
4	Tema e diplomës	-
5	Punë individuale	900 orë
*	Totali	1500 orë

Viti i dytë		
Nr	Emërtimi i vep. formuese	Ngarkesa/orë
1	Leksione	300 orë
2	Seminare,ushtrime,detyr kursi, etj.	300 orë
3	Praktika profesionale	150 orë
4	Tema e diplomës	180 orë
5	Punë individuale	570 orë
*	Totali	1500 orë

Këto raporte sigurojnë një kombinim efektiv midis njohurive teorike dhe aftësive praktike përmes leksioneve, seminareve, ushtrimeve, detyrave të kursit, praktikës profesionale dhe temës së diplomës. Kjo qasje u mundëson studentëve të zhvillojnë kompetenca profesionale dhe të përmbushin objektivat e të nxënimit të programit të studimit. Struktura e programit, e ndarë sipas veprimtarive formuese, si dhe ekuilibri midis komponentëve teorikë dhe praktikë, krijon mundësi për arritjen e objektivave akademike, lehtëson transferimin e studimeve dhe mobilitetin e studentëve, duke rritur gjithashtu perspektivat e tyre për punësim pas diplomimit.

Evidenca 2.7 Plani mësimor i programit të studimit

Evidenca 2.8 Programet lëndore të programit të studimit

Evidenca 4.1 Tabela Permbledhese Per Programin E Studimit (tabela nr 10)

<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqëruar dhe diskutimeve të zhvilluara me Përgjegjësën e Departamentit dhe stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi, u konfirmua se syllabuset dhe programet e lëndëve përditësohen periodikisht. Shumica e lëndëve zhvillohen me tekste universitare, të cilat studentët mund t'i konsultojnë edhe në bibliotekën e Fakultetit të Ekonomisë.</p> <p>Bazuar në të dhënat e aneksit mbi programet e lëndëve, GVJ vëren se çdo syllabus përmban informacion të detajuar, duke përfshirë titullin e lëndës, përgjegjësën akademik, ngarkesën në orë dhe kredite, tipologjinë e lëndës, vitin dhe semestrin në të cilin zhvillohet, kategorinë e saj, përshkrimin e tematikave, literaturën bazë dhe mbështetëse, si dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive.</p> <p>Pas shqyrtimit të dosjes së syllabuseve, GVJ konstaton se ato përgjithësisht sigurojnë transmetimin e njohurive të nevojshme për studentët, në përputhje me kërkesat e tregut të punës. <i>GVJ rekomandon që stafi akademik të vijojë me përditësimin e rregullt të literaturës bazë dhe ndihmëse për të garantuar përputhshmërinë me zhvillimet më të fundit në fushën përkatëse.</i></p> <p><i>Evidenca 2.8 Programet lëndore të programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.15 Dokument për ndryshimet në planin mësimor</i> <i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të MSH në Financë mundëson zhvillimin e dijeve dhe aftësive të studentëve. Programi fillon me lëndë bazë, që ofrojnë një formim të përgjithshëm në fushën e financës gjatë vitit të parë, dhe kalon në lëndë më të specializuara dhe profesionale në vitin e dytë, të fokusuar në fushën e programit. Ky program i studimit kombinon trajtimin teorik me aplikimin praktik, veçanërisht në lëndët e financës, për t'u siguruar që studentët të jenë të përgatitur për sfidat e profesionit.</p> <p><i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i> <i>Evidenca 2.7 Plani mësimor i programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmes shqyrtimit të rregullores dhe dosjes së plotë të programit të studimit MSH në "Finance", u vërejt se ky program ofron mundësi të shkëlqyera për studentët për të pozicionuar karrierën e tyre të ardhshme. Programi ka si qëllim zhvillimin e aftësive teorike dhe profesionale të studentëve, duke i përgatitur ata për tregun e punës. Sipas komenteve të shprehura nga GVJ ndaj Dekanit dhe Përgjegjës të Departamentit, u sugjerua që disa lëndë të zëvendësohen me lëndë më bashkëkohore për të përmirësuar përmbajtjen e programit dhe për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut.</p> <p><i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i> <i>Evidenca 2.7 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.8 Programet lëndore të programit të studimit</i></p>

Konkluzione	<i>GVJ, duke u bazuar në dokumentacionin e siguruar nga institucioni dhe vizitën e realizuar në institucion, konkludon se programi i studimit Master Shkencor në "Finance" përmbush plotësisht objektivat formuese dhe nivelin kualifikues sipas Kuadrit Kombëtar dhe Europian të Kualifikimeve. Ky program i mundëson studentëve të diplomuar të jenë të përgatitur dhe të kualifikuar për t'u integruar në tregun financiar.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>Departamenti i Financë-Kontabilitet (DFK), si njësi bazë dhe përgjegjëse për këtë program, ka bërë përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e programeve që mbulon, duke u mbështetur në marrëveshjet institucionale me aktorët e tregut të punës. Në lidhje me këtë program, është evidentuar se përmirësimet janë kryesisht të fokusuar në lirinë akademike të stafit, duke përfshirë rifreskimin e literaturës.</p> <p>Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit të UNIKO, u vu re se mungon një studim i fundit i tregut të punës, i cili do të mundësonte një orientim më të saktë të zhvillimit të programit dhe mundësive të punësimit për të diplomuarit. Pavarësisht që institucioni ka hartuar Planin dhe Strategjinë e Zhvillimit për periudhën 2022-2027, ky dokument nuk përfshin një analizë të plotë të tregut të punës.</p> <p><i>Evidenca 1.3 Plani Strategjik I Zhvillimit të UNIKO</i> <i>Evidenca 3.22 Propozime të diskutuara në mbledhjet e departamentit të datave 30/06/2021 dhe 12/07/2021 në kontekst të rishikimit periodik të programeve të studim</i> <i>Vizita në institucion e GVJ dhe takim me stafin akademik dhe studentet</i></p>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	<p>Diskutimi dhe vlerësimi i studentëve në lidhje me programin mësimor dhe metodat e mësimdhënies realizohet përmes bisedave direkte me pedagogët e lëndëve dhe përmes instrumenteve të vlerësimit, siç janë anketa anonime, ku studentët shprehin mendimet e tyre për lëndën dhe pedagogët përkatës. Institucioni ruan një lidhje të vazhdueshme me studentët e diplomuar, përmes Qendrës së Karrierës dhe Alumni (QKA), e cila është përgjegjëse për kontakte me ta. Po ashtu, këshillat studentore të zgjedhura janë pjesë e këtij procesi, duke kontribuar në mbledhjen dhe shqyrtimin e mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve.</p> <p><i>Evidenca 3.20 Analiza Vjetore Qendra e Karrierës e Alumit.</i> <i>Evidenca 3.13 Pyetësori Studentor Fund Kursi</i> <i>Evidenca 3.35 Pyetësor alumni dhe relacioni</i></p>

<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Siç u theksua më herët, përmirësimet në program janë kryesisht të fokusuar në përditësimin e syllabuseve dhe në lirinë akademike që stafi i këtij programi ka, me synimin për të pasqyruar zhvillimet më të fundit në tregun e punës. <i>Megjithatë, një analizë e drejtpërdrejtë e tregut të punës lidhur me këtë program do të mundësonte ndryshime të fokusuara në përmbajtje dhe përmirësimin e cilësisë për t'u përshtatur më mirë me kërkesat e këtij tregu.</i></p> <p><i>Evidenca 3.22 Propozime të diskutuara në mbledhjet e departamentit të datave 30/06/2021 dhe 12/07/2021 në kontekst të rishikimit periodik të programeve të studim</i> <i>Vizita në institucion e GVJ dhe takim me stafin akademik dhe studentet</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni dhe vizitën e realizuar, konkludon se përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit dhe vlerësimit të programit përmbush standardet e kërkuara dhe shërben si një hap i rëndësishëm për përmirësimin e mëtejshëm të tij. GVJ sugjeron realizimin e një studimi të plotë të tregut të punës, me fokus në mundësitë e punësimit në fushën e financës dhe në institucionet financiare për studentët e këtij programi.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p>Standardi II.6 Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit është i ndërtuar në përputhje me objektivat e institucionit. Programi i ciklit të dytë të studimit Master Shkencor "Financë", bazohet në Ligjin Nr 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH", Ky program studimi sipas rregullores së programit ka si mision t'i pajisë studentët me një sistem bazë njohurish që i formon ata në fushën e financës.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Bazuar në listën e bashkëpunimit ndërinstitucional të UNIKO, vihet re se ky institucion synon zhvillimin e një bashkëpunimi akademik në fushat e edukimit, formimit teoriko-profesional, të kërkimit shkencor si edhe në fusha të tjera, me fokus në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkëmbim përvoja të stafit akademik; - Pjesëmarrje në kërkime dhe projekte të përbashkëta; -Organizim të konferencave apo simpoziumeve shkencore të përbashkëta <p><i>Evidenca 2.2 Rregullorja e brendshme të Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca 2.3 Rregullorja e Departamentit Financë-Kontabilitet</i></p>

	<i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i>			
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit Master Shkencor në "Financë" mundëson dhe motivon studentët të angazhohen në studime të thelluara, projekte dhe aktivitete kërkimore. Ai ofron mundësinë që studentët të punojnë ngushtë me pedagogët në temën e diplomës dhe i inkurajon ata të marrin pjesë në projekte të ndryshme. Për më tepër, programi nxit pjesëmarrjen e studentëve në konferenca studentore, si brenda UNIKO ashtu edhe në universitete të tjera, duke i mundësuar ata të prezantojnë kërkimet e tyre në fushat përkatëse të studimit. <i>Evidenca 2.24 Pjesëmarrja e studenteve në projekte.</i> <i>Evidenca 2.28 Pjesëmarrja e studentëve në Konferenca studentore.</i> <i>Evidenca 3.26 Marrëveshje bashkëpunimi me Universitete dhe Fakultete</i>			
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Sipas Rregullores së UNIKO-së dhe Rregullores të FE, është e parashikuar financimi i aktiviteteve studimore, kërkimore dhe shkencore përmes projekteve të ndryshme, ku mund të aplikojnë pedagogë individualisht ose në grupe. Shuma e financimit për secilin projekt përcaktohet në varësi të buxhetit të miratuar dhe prioriteteve të zhvillimit të institucioneve. Rregullorja e UNIKO-së përcakton se aktivitetet kërkimore-shkencore që mbështeten nga ky institucion janë të dokumentuara në nenin 115. <i>Evidenca 1.2 Rregullorja e UNIKO neni 103, pika 9; neni 107; neni 115</i> <i>Evidenca 2.2 Rregullorja e brendshme të Fakultetit të Ekonomisë neni 116, pika 8</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se Programi i studimit Master Shkencor në "Financë" ofron një strukturë të mirëorganizuar që mundëson përgatitjen e studentëve me njohuri teorike dhe praktike në fushën e financës. Përmes rregulloreve të UNIKO-së dhe FE, mundësohen mundësi për angazhimin e studentëve në projekte dhe aktivitete kërkimore, të cilat financohen dhe mbështeten nga institucionet përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për	Bazuar në evidencat përkatëse të dhënave të kërkimit shkencor dhe bashkëpunimeve shkencore në nivel fakulteti, si dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit për realizimin e programit të "Masterit Shkencor në Financë", u evidentua se njësia përgjegjëse mbështet projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunim me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit. Megjithatë,

realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	<p>është vënë re se nuk ka një përfshirje të gjerë të pedagogëve në projekte kërkimore-shkencore ndërkombëtare, gjë që mund të ndikojë në zgjerimin e mundësive për kërkim dhe bashkëpunim ndërkombëtar.</p> <p><i>Evidenca 2.10 Marrëveshje Bashkëpunimi Në Mbështetje Të Praktikave Profesionale Vizita e GVJ dhe takimi me stafin akademik</i></p>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	<p>Bazuar në rregulloren e Departamentit të Financë-Kontabilitet dhe rregulloren e programit të studimit Master Shkencor në "Financë", theksojmë se njësia përgjegjëse ka për qëllim angazhimin e stafit akademik dhe studentëve në projekte dhe kërkime shkencore. Megjithatë, ky angazhim ka ende nevojë për rritje dhe zhvillim më të madh.</p> <p><i>Evidenca 2.3 Rregullorja e Departamentit Financë-Kontabilitet Evidenca 2.34 Veprimtari të organizuara në kuadër të projekteve Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i></p>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	<p>Njësia përgjegjëse ka organizuar tryeza të rrumbullakëta dhe leksione të hapura me ekspertë nga tregu i punës. Gjithashtu, pedagogët e DFK-së kanë marrë pjesë në konferencën shkencore ASCEU, të organizuar nga UNIKO më 17.06.2022. GVJ rekomandon që numri i aktiviteteve shkencore dhe pjesëmarrja në konferenca të rritet në vijim.</p> <p><i>Evidenca 3.5 Konferenca e ASECU, leksione të hapura me specialistë, tryeza të rrumbullakëta</i></p>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	<p>Bazuar në evidencën nr 4.3 mbi gjurmimin e studentëve si dhe në evidencën nr 3.6 mbi raportin e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për realizimin e programit të studimeve (2023-2024), konstatohet se njësia bazë e programit të Masterit Shkencor në "Financë" përgatit profesionistë konkurrues për tregun kombëtar të punës.</p> <p><i>Evidenca 4.3 Të dhëna mbi gjurmimin e studentëve të diplomuar 2021-2024 Evidenca 3.6 Raporti I Përfitimeve Nga Marrëveshjet Në Funkcion Të Programit Të Studimit</i></p>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	<p><i>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi</i></p>
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në	<p><i>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi</i></p>

vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).									
Konkluzione	<i>GVJ thekson nevojën për një angazhim më të madh të njësisë përgjegjëse të programit të studimit në rritjen e aktiviteteve shkencore. Kjo përfshin përfshirjen më aktive të studentëve dhe pjesëmarrjen e zgjeruar në projekte kërkimore, duke kontribuar kështu në zhvillimin akademik dhe profesional të tyre..</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënësve dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytë "Master Shkencor" në Financë, si dhe në planin mësimor dhe syllabuset përkatëse, u konstatua se metodat kryesore të procesit mësimor në Fakultetin e Ekonomisë (FE), Departamentin e Financë-Kontabilitet në UNIKO, përfshijnë leksionet, seminarat, detyrat e kursit dhe temat e diplomës. Sipas planit mësimor, orët mësimore në auditor dhe angazhimi individual i studentëve janë përcaktuar në përputhje me të gjitha elementet që përbëjnë një program të nivelit "Master Shkencor". <i>Evidenca 2.7 Plani Mësimor i Programit të Studimit</i> <i>Evidenca 2.8 Programet lëndore të programit të studimit 22-23;23-24;24-25</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Në përputhje me rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë (FE) dhe programin e studimit të ciklit të dytë "Master Shkencor" në Financë, procesi mësimor mbështetet nga një staf akademik dhe ndihmës akademik i kualifikuar, i cili angazhohet në mënyrë aktive për të përmbushur diversitetin dhe nevojat e studentëve. <i>Evidenca 2.2 Rregullorja e brendshme të Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca 2.8 Programet lëndore të programit të studimit 22-23;23-24;24-25</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

30

<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>UNIKO mbështet zhvillimin profesional të pedagogëve duke promovuar metoda inovative të mësimdhënies, leksione të hapura dhe shkëmbim përvojash me institucione homologe. Gjithashtu, ka përmirësuar infrastrukturën akademike përmes mbështetjes teknike të platformave online dhe krijimit të laboratorëve për mësimin në distancë e klasave hibride, duke ofruar një mjedis mësimor më efikas dhe fleksibël.</p> <p><i>Evidenca 3.5 Konferenca e Asecu, Leksione Të Hapura Me Specialistë, Tryeza Të Rrumbullakëta</i> <i>Evidenca 3.21 Tryeza E Rrumbullaket Organizuar Në Datën 28.06.2021 Nga Departamenti</i> <i>Vizita e GVJ në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në këtë program ka kualifikimet dhe përvojën e nevojshme për të garantuar një mësimdhënie cilësore. Nga CV-të e tyre vërehet se shumica kanë një formim të thelluar akademik dhe profesional në fushën e Financës, si dhe në disiplinat përkatëse. Gjatë takimit me studentët e programit, u vërejt një bashkëpunim efektiv dhe i ndërsjellë mes tyre dhe stafit akademik.</p> <p><i>Evidenca 2.7 Plani Mësimor i Programit të Studimit</i> <i>Evidenca 2.9 Jetshkrimet e stafit akademik të programit të studimit.</i> <i>Vizita e GVJ në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Departamenti i Financë-Kontabilitetit, në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), kryen një vlerësim të vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies, duke përfshirë vlerësimet nga eprorët, monitorimin e procesit mësimor dhe mbledhjen e feedback-ut nga studentët. Gjatë vizitës së GVJ në UNIKO, u konstatua se aftësitë pedagogjike të stafit akademik dhe ndihmës akademik vlerësohen dhe monitorohen në mënyrë periodike. Në UNIKO, rrjeti i Cilësisë përbëhet nga Sektori i Kurrikulës, Vlerësimi Institucional dhe Alumni (SKVIA), i ngritur brenda Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimi Institucionale (DKVI). Ky sektor (SKVIA) ndjek dhe siguron kontrollin e cilësisë për arritjen e standardeve akademike, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor. Përveç kësaj, NJSBC fokusohet në implementimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe vlerësim, përfshirjen e studentëve në procesin e të nxënit dhe identifikimin e problematikave përkatëse. Njësia, përmes një përfaqësuesi koordinator nga çdo njësi kryesore, mbikëqyr procesin e vlerësimi të mësimdhënies, analizon modele të ndryshme dhe vlerëson aktivitetet që lidhen me shërbimet akademike dhe administrative.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimi të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë</p>	<p>Departamenti i Financë-Kontabilitetit, në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), kryen një vlerësim të vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies, duke përfshirë vlerësimet nga eprorët, monitorimin e procesit mësimor dhe mbledhjen e feedback-ut nga studentët. Gjatë vizitës së GVJ në UNIKO, u konstatua se aftësitë pedagogjike të stafit akademik dhe ndihmës akademik vlerësohen dhe monitorohen në mënyrë periodike. Në UNIKO, rrjeti i Cilësisë përbëhet nga Sektori i Kurrikulës, Vlerësimi Institucional dhe Alumni (SKVIA), i ngritur brenda Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimi Institucionale (DKVI). Ky sektor (SKVIA) ndjek dhe siguron kontrollin e cilësisë për arritjen e standardeve akademike, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor. Përveç kësaj, NJSBC fokusohet në implementimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe vlerësim, përfshirjen e studentëve në procesin e të nxënit dhe identifikimin e problematikave përkatëse. Njësia, përmes një përfaqësuesi koordinator nga çdo njësi kryesore, mbikëqyr procesin e vlerësimi të mësimdhënies, analizon modele të ndryshme dhe vlerëson aktivitetet që lidhen me shërbimet akademike dhe administrative.</p>

përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	<p><i>Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Kreu IX, Neni 84 Pika 1&2</i></p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DKVI (Kreu III, Neni 6, pika 2); (Kreu V, Neni 13, pika 5)</i></p> <p><i>Evidenca 3.13 Pyetësor studentor fund kursi</i></p> <p><i>Evidenca 3.17 Relacion në përfundim të modulit.</i></p> <p><i>Evidenca 3.7 Raportet Vjetore të NJSBC 21-22;22-23;23-24</i></p> <p>https://unkorce.edu.al/26223-2/;</p> <p>https://unkorce.edu.al/studentet-qendra-e-karrieres-dhe-alumni/.</p> <p><i>Vizita e GVJ në Institucion</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Sa i përket standardit III.1, GVJ vlerëson se stafi akademik është i kualifikuar dhe i angazhuar në mbështetje të studentëve. UNIKO, përmes leksioneve të hapura dhe debateve të organizuara brenda institucionit, synon modernizimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies. Gjatë takimit të GVJ me stafin akademik u konfirmua se, synohet nxitja dhe zhvillimi i mësimin në mënyrë interaktive me studentët gjatë zhvillimit të leksioneve dhe seminareve, punës individuale dhe në grup.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Në rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytë master shkencor në "Financë", syllabuset e lëndëve përkatëse përcaktojnë format e kontrollit të dijeve të studentëve. Programet e lëndëve specifikojnë qartë mënyrën e vlerësimit për secilën lëndë, duke përfshirë përbërësit e vlerësimit, përqindjet përkatëse për secilën pjesë dhe shpjegimet e nevojshme. Gjatë vëzhgimit të disa syllabuseve nga GVJ, u konstatua se asnjë nga syllabuset e programit të Masterit Shkencor në "Financë" nuk ishin hartuar në përputhje me formatin e shtojcës nr. 2 të VKM nr. 41, datë 24.01.2018.</p> <p><i>Evidenca 2.2 Rregullorja e brendshme të Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>Evidenca 2.3 Rregullorja e Departamentit Financë-Kontabilitet</i></p> <p><i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i></p> <p><i>Evidenca 2.8 Programet lëndore të programit të studimit</i></p>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të	<p>Në fillim të procesit mësimor, pedagogu i lëndës bën një prezantim të detajuar të përmbajtjes së lëndës, objektivave, temave të testimit dhe metodave të vlerësimit të njohurive, si dhe elementëve të tjerë të syllabusit. Ky informacion mundësohet gjithashtu përmes sistemit</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

32

njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	elektronik PITAGORA, ku çdo student mund të aksesojë informacionin e nevojshëm në llogarinë e tij. Bazuar në syllabuset e pedagogëve për programin e studimit të ciklit të dytë Master Shkencor në "Financë", është e dukshme se pedagogu informon studentët për mënyrën e vlerësimit të dijeve si në fillim të procesit mësimor, ashtu edhe nëpërmjet sistemit elektronik PITAGORA.		
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Duke u bazuar në syllabuset e lëndëve, vërehet se kontrolli i dijeve realizohet gjatë procesit mësimor përmes pjesëmarrjes dhe angazhimit të studentëve në leksione, seminare, detyra kursi, si dhe në provimet ndërmjetëm dhe përfundimtar. Në programet e lëndëve të ciklit të dytë Master Shkencor në "Financë", specifikohet qartë mënyra e vlerësimit, përbërësit e tij dhe përqindjet përkatëse për testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive. Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë zhvillimit të lëndës/modulit, duke përfshirë teste të ndërmjetme (me shkrim ose me gojë), ese, detyra/projekte kursi, punë në grup, prezantime, dhe përfundon me provimin final (me shkrim ose me gojë, sipas përshkrimit në programin lëndor përkatës).		
Konkluzione	<i>Evidenca 2.2 Rregullorja e brendshme të Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca 2.3 Rregullorja e Departamentit Financë-Kontabilitet</i> <i>Evidenca 2.8 Programet lëndore të programit të studimit</i> <i>Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nga institucioni dhe vizitës së realizuar, GVJ konkludon se UNIKO disponon një kuadër të plotë rregullator, mbikëqyrës dhe procedural për vlerësimin e dijeve të studentëve gjatë procesit mësimor.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Duke u bazuar në rregulloren e Departamentit të Financë-Kontabilitetit dhe në rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Financë", u konstatua se kontrolli i dijeve realizohet duke kombinuar vlerësimin e vazhdueshëm gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit, me vlerësimin në provim. Vlerësimi i vazhdueshëm përfaqëson 30% të vlerësimit total, siç është parashikuar në çdo syllabus të lëndëve. Kjo metodë vlerësimi ofron mundësinë që studentët të angazhohen gjatë gjithë semestrit dhe siguron një vlerësim më objektiv të kontributit të tyre, si në auditor, ashtu edhe jashtë tij.

	<i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Format e testimit dhe vlerësimit janë të kombinuara, duke përfshirë provime me shkrim dhe me gojë, sipas rregullores së programit të Masterit të Shkencave në "Financë". Gjatë vizitës së GVJ në UNIKO, u prezantua platforma "PITAGORA", e cila ofron mundësinë për studentët të marrin vlerësimet e tyre përmes kësaj platforme. <i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i> <i>Evidenca 3.33 Model procesverbal i gjeneruar nga sistemi</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Për programin e ciklit të dytë "Master Shkencor në "Financë", vlerësimet përfundimtare të lëndëve realizohen në përputhje me syllabuset përkatëse. <i>Evidenca 2.8 Programet lëndore të programit të studimit</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Në përputhje me rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytë "Master Shkencor në Financë", studentët informohen dhe këshillohen vazhdimisht për të përmirësuar ecurinë e tyre akademike. Në FE është implementuar projekti "CleanScore", i cili vë në zbatim një sistem elektronik të vlerësimit për testimet dhe provimet, krahas vlerësimit elektronik që realizohet nëpërmjet platformave online si Google Classroom dhe Office 365 for Education. Përveç kësaj, vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përfshin seanca rishikimi për provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, ku pedagogët ofrojnë komente dhe feedback për studentët. <i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i> <i>Evidenca 3.33 Model procesverbal i gjeneruar nga sistemi</i> <i>Evidenca 3.18 Korigjimi i automatizuar i provimeve</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Sipas rregullores së Fakultetit të Ekonomisë dhe programit të studimit të ciklit të dytë "Master Shkencor në Financë", testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve, të cilat emërohen nga përgjegjësi i departamentit për administrimin e provimeve. Gjithashtu, ky komision ndalon kopjimin gjatë provimeve dhe detyrave. <i>Evidenca 2.2 Rregullorja e brendshme të Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Sipas rregullores Institucionale dhe rregullores së programit të studimit të ciklit të dytë "Master Shkencor në Financë", rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritat e përcaktuara nga aktet rregullatore institucionale. Pedagogu u bën me dije studentëve rezultatet e provimit brenda 6 ditëve nga data e zhvillimit të tij. Rezultatet e provimeve publikohen brenda një periudhe prej 8 ditësh nga data e zhvillimit të provimit, ku pedagogu i publikon ato online dhe i dorëzon në Sektorin e Studimeve dhe në

	<p>Sektorin e TIK-ut, përmes të cilëve studentët informohen për rezultatet e tyre.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i></p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Sipas rregullores së FE dhe programit të studimit të "Masterit Shkencor në Financë", rezultatet paraprake shfaqen në librezën elektronike të studentëve. Pas marrjes së rezultateve, studentët kanë të drejtë të kërkojnë rishikimin e tyre dhe mund të ankimojnë nëse janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nëse nuk bien dakord me vlerësimin e bërë.</p> <p>Ankesa mund të bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit me gojë dhe jo më vonë se 8 ditë për provimet me shkrim, nga data e zhvillimit të tyre, dhe i drejtohet Dekanit të Fakultetit.</p> <p>Në rastet e ankimimit të rezultateve, sipas rregullores së ankimimeve, studentët i drejtohen Departamentit të Financë-Bankës, i cili formon një komision për të shqyrtuar ri-vlerësimin e provimit.</p> <p><i>Evidenca 2.2 Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë, Kreu X, Neni 85</i> <i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i></p>			
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p><i>GJVJ, duke u bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni dhe vizitën e realizuar, konkludon se arrihet një vlerësim i drejtë i dijeve të studentëve, duke respektuar konfidencialitetin, paanësinë dhe të drejtën e ankimimit nga studentët, si dhe procesin e zgjidhjes së ankimimeve.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GJVJ, duke u bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni dhe vizitën e realizuar, konkludon se arrihet një vlerësim i drejtë i dijeve të studentëve, duke respektuar konfidencialitetin, paanësinë dhe të drejtën e ankimimit nga studentët, si dhe procesin e zgjidhjes së ankimimeve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

<p>Standardi III.4 Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor të programit të ciklit të dytë Master Shkencor në "Financë", vihet re se programi garanton përvetësimin e thelluar të njohurive dhe zhvillon aftësitë profesionale dhe shkencore të studentëve në fushën e financave. Duke u mbështetur në syllabuset dhe modulet që ofron programi, si dhe në përfshirjen e praktikës profesionale, programi ka si objektivi kryesor formimin teorik, profesional dhe shkencor të studentëve.</p> <p><i>Evidenca 2.7 Plani Mësimor i Programit të Studimit</i> <i>Evidenca 2.8 Programet lëndore të programit të studimit</i></p>

<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Referuar programit të ciklit të dytë MSH në “Financë” dhe syllabuseve të lëndëve, vihet re zhvillimi i aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, si dhe aftësive humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit. Gjithashtu, disa lëndë të programit ofrojnë një trajtim të thelluar të aftësive për menaxhimin e informacionit, si p.sh. “Marketingu i shërbimeve financiare” dhe “Vlerësimi financiar i biznesit”.</p> <p><i>Evidenca 2.7 Plani Mësimor i Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Në programin e studimit MSH në “Financë”, kompetencat dhe aftësitë e studentëve shqyrtohen në përfundim të lëndës, duke u bazuar në formatet e përcaktuara nga syllabus-et. Kontrolli i dijeve realizohet i kombinuar i vlerësimit të vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit, bashkë me vlerësimin në provim, përfshin elementë të ndryshëm të vlerësimit, si testime të ndërmjetme (me shkrim dhe gojë), ese, detyra/projekte kursi, etj. Gjatë monitorimeve, u evidentua një komunikim i hapur midis pedagogëve dhe studentëve për përmirësimin e metodave të mësimdhënies, ndërkohë që vlerësimi dhe monitorimi i procesit mësimor kontribuojnë në zhvillimin e aftësive të studentëve. Rregullorja e programit nxit gjithashtu autonominë e studentëve dhe mundëson konsulta me pedagogët për të adresuar sfidat akademike.</p> <p><i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në “Financë”</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Në Fakultetin e Ekonomisë (FE), Departamenti i Financë-Kontabilitet në UNIKO, mësimdhënia bazohet në një kombinim të leksioneve, seminareve, detyrave të kursit dhe temave të diplomës, duke respektuar standardet e programit “Master Shkencor”.</p> <p>Personeli akademik, i përbërë nga profesionistë të kualifikuar dhe me eksperiencë të gjerë, mbështet diskutimet, punën në grup dhe udhëzon studentët në interpretimin dhe zgjidhjen e çështjeve komplekse. Po ashtu, UNIKO ka si synim përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke krijuar një atmosferë që inkurajon idetë inovative dhe kërkimin shkencor.</p> <p><i>Evidenca 2.3 Rregullorja e Departamentit Financë-Kontabilitet</i> <i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në “Financë”</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe</p>	<p>Personeli akademik i kualifikuar dhe i angazhuar realizon leksione të hapura dhe debate për zhvillime të reja në shkencë dhe teknologji, brenda dhe jashtë strukturës së programit të studimit.</p>

seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Institucioni mbështet nxitjen e ideve inovative dhe inkurajon studentët të angazhohen në studime të përparuara kërkimore.			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	<i>Evidenca 3.21 Tryeza E Rrumbullaket Organizuar Në Datën 28 06 2021 Nga Departamenti</i> <i>Evidenca 3.5 Konferenca e Asecu, Leksione Të Hapura Me Specialistë, Tryeza Të Rrumbullakëta</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni krijon struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat kontribuojnë në rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit. Në lidhje me standardin III.4, GVJ vlerëson se ai përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	<p>Në përputhje me rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë dhe rregulloren e programit të studimit për përgatitjen e punimit të diplomës, studenti i programit të ciklit të dytë MSH në "Financë" ka të drejtë të diplomohet përmes mbrojtjes së diplomës. Të gjitha procedurat specifike për mbrojtjen e diplomës hartohen nga institucioni dhe bëhen publike për të gjithë studentët.</p> <p><i>Evidenca 2.2 Rregullorja e brendshme të Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i></p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	<p>Në përputhje me rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë dhe rregulloren e programit të studimit, strukturat përgjegjëse, si Departamenti, Sekretaria Mësimore dhe pedagogët udhëheqës, janë të detyruar të ofrojnë asistencë për studentët gjatë procesit të mbrojtjes së diplomës.</p> <p><i>Evidenca 2.2 Rregullorja e brendshme të Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë"</i> <i>Evidenca 2.31 Udhezuesi I Diplomes Master i Shkencave ne Finance.</i></p>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/	<p><i>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi</i></p>

<p>modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Referuar rregullores së Fakultetit të Ekonomisë, u vërejt se Personeli akademik në departamentin e Financë-Kontabilitetit ka detyrim të mentorojë dhe ndihmojë çdo student që ka nevojë për orientim në zgjedhjen e temave dhe fushave përkatëse.</p> <p>UNIKO siguron bazën materiale të nevojshme për zhvillimin e temës së diplomës. Temat udhëhiqen nga pedagogët e fakultetit që kanë titull ose gradë shkencore.</p> <p>Pas mbrojtjes finale, komisioni përgjegjës përcakton notën finale. Në përputhje me Rregulloren e UNIKO, rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë dhe rregulloren e Departamentit të Financë-Kontabilitetit, punimi i diplomës mbrohet para komisionit të përcaktuar.</p> <p>Rezultatet hidhen në sistem dhe procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit të diplomimit, si dhe nga personat e tjerë përgjegjës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p><i>Evidenca : 2.2 Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë, Kreu VI, Neni 47, Pikat (1)</i></p> <p><i>Evidenca : 2.5 Rregullore e programit të studimit, seksioni 5 dhe seksioni 7.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p><i>Evidenca 3.34 Formati i vlerësimit të punimit të diplomës nga opONENTI, udhëheqësi i temës dhe kriteret e vlerësimit.</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Bazuar në formatin e diplomës së masterit shkencor në "Financë", rregullores së UNIKO, rregullores së Fakultetit të Ekonomisë, rregullores së Departamentit të Financë-Kontabilitetit dhe rregullores së programit të studimit, u vërejt se në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën, duke fituar titullin Master Shkencor në "Financë".</p> <p>Sipas RVB-së, elementet përbërëse dhe forma e diplomës janë në përputhje me kërkesat e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. Gjithashtu, studentit i ofrohet një kopje zyrtare e plotë e programit të studimit të realizuar.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullorja e UNIKO</i></p> <p><i>Evidenca : 2.2 Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë, Kreu VI, Neni 47, Pikat (1)</i></p> <p><i>Evidenca : 2.5 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 2.6 Modeli Diplomës suplementit të Programit të Studimit.</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Dokumentacioni i regjistrimit të studentit ruhet në Sektorin e Studimeve edhe pas diplomimit të tij. Të dhënat e tjera, si arritjet akademike, informacioni i diplomimit, numri i diplomës, data e diplomimit dhe nota e diplomës, ruhen dhe mund të vihen në dispozicion të studentit nëpërmjet kërkesës së tij.</p>

	<i>Evidenca 2.2 Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë, Kreu XV, Neni 113</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se është vërejtur se strukturat përgjegjëse, në UNIKO ofrojnë asistencë dhe mbështetje të vazhdueshme për studentët gjatë procesit të mbrojtjes së diplomës. Ky proces është në përputhje me rregulloret përkatëse dhe siguron një vlerësim të drejtë dhe të qartë të punimeve të diplomës. Të dhënat dhe rezultatet janë të dokumentuara dhe të aksesueshme për studentët, duke garantuar transparencën dhe standardet e larta të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	<i>Ky standard nuk aplikohet për këtë program studimi</i>			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.				
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	

--	--	--	--	--

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht nenet 57, 59 dhe 66 të ligjit 80/2015, nenet 41 dhe 48 të Statutit të UK, si dhe nenet 27 dhe 36 të Rregullores së UK, referuar RVB, Fakulteti Ekonomik garanton që stafi i angazhuar mbulon lëndët dhe modulet në nivel profesional dhe ka përvojë akademike disa vjeçare të përshtatshme me natyrën e programit MSH "Financë". GVJ konstaton se, pavarësisht se stafi akademik ka disa artikuj të publikuar në revista shkencore të indeksuara, këshillohet që stafi akademik të ketë më shumë angazhim në drejtim të publikimit të artikujve me faktor impakti si edhe eksperiencë aplikative përsa mund të afrojnë rajoni Korçës.</p> <p><i>Evidencat: [Ligj Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Shtojca 1.1 Statuti i UK; Shtojca 1.2 Rregullorja e UNIKO; Shtojca 2.26 Të dhëna për personelin akademik të departamentit Financë-Kontabilitet; Linku 5.7 Staf i Departamentit të Financë-Kontabilitet https://unkorce.edu.al/departamenti-i-finance-kontabilitet/; Shtojca 2.9 Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në programin e studimit; Shtojca 2.9 Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në programin e studimit; Shtojca 2.5 Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave në Financë"; Shtojca 4.4 Kualifikimi dhe kerkimi shkencor të dhëna mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore të Departamentit Financë-Kontabilitet.]</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Ky program ofrohet nga Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit të Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Korçës dhe është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të këtij fakulteti, që është njësi përgjegjëse për ofrimin e tij. Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit është strukturuar dhe plotëson kërkesat e Nenit 25, pika 4 të Ligjit 80/2015. Në këtë departament janë 14 PAE, ku 92% e PAE kanë tituj apo gradë shkencore, specifikisht janë: 5 profesorë të asociuar, 7 me gradën doktor i shkencave dhe 1 student doktorature. Për realizimin e lëndëve të programit të studimit MSC "Financë", janë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

40

	<p>angazhuar staf akademik si në vijim: 1 profesor, 5 profesorë të asociuar, 8 doktorë shkencash dhe 1 PAE me Msc, në kundërshtim me kuadrin ligjor e rregullator. GVJ ia bëri të ditur këtë drejtuesve gjatë vizitës në IAL.</p> <p><i>Evidencat: [Ligj Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Shtojca 1.1 Statuti i UK; Shtojca 1.2 Rregullorja e UNIKO; Shtojca 2.26 Të dhëna për personelin akademik të departamentit Financë-Kontabilitet; Linku 5.7 Staf i Departamentit të Financë-Kontabilitet https://unkorce.edu.al/departamenti-i-finance-kontabilitet/; Shtojca 2.9 Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në programin e studimit; Shtojca 2.9 Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në programin e studimit; Shtojca 2.5 Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave në Financë"; Shtojca 4.4 Kualifikimi dhe kerkimi shkencor të dhëna mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore të Departamentit Financë-Kontabilitet; Shtojca 4.2 Tabela përmbledhëse e ngarkesave të realizuara të personelit efektiv në nivel fakulteti në fund të çdo viti.]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Stafi akademik i Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit, përveç angazhimit në programin e studimit MSC në "Financë" është i angazhuar edhe në programe të tjera të studimit të ofruara nga UNIKO. Referuar nenit 57 pika 2, 59 të Ligjit 80/2015, specifikimeve në VKM Nr. 329, datë 12.4.2017, si dhe në Statutit të UNIKO, nenit 39 dhe 41, nuk konstatojmë mos respektim të tyre lidhur me sa parashikuar dhe kontrollit të bërë gjatë vizitës në IAL për dosjet e personelit të kontrolluara. Duke pasë në konsideratë se ky program studimi zhvillohet në një universitet shtetëror, atëherë GVJ evidenton se ka qëndrueshmëri në personelin akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit me kontrata pa afat të punësimit dhe shlyerjen e detyrimeve për sigurime shoqërore, shëndetësore dhe pagesë të tatimit në burim mbi të ardhurat nga punësimi i tyre. Të gjitha sa më sipër sipas GVB në përputhje me Ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Ligjin Nr. 10 383, datë 24.02.2011 "Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", si dhe me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë të ndryshuar. VKM nr. 329, datë 02.04.2017.</p> <p><i>Evidencat: [Shtojca 2.26 Të dhëna për personelin akademik të departamentit Financë-Kontabilitet; iknu 5.7 Staf i Departamentit të Financë-Kontabilitet https://unkorce.edu.al/departamenti-i-finance-kontabilitet/; Shtojca 2.9 Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në programin e studimit; Shtojca 2.9 Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në programin e studimit; Shtojca 4.2 Tabela përmbledhëse e ngarkesave të realizuara të personelit efektiv në nivel fakulteti në fund të çdo viti; Shtojca 1.4 Rregullorja e Drejtorise Juridike dhe Burimeve Njerezore; Shtojca 3.29 Model i kontratës individuale të punës]</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në nenin 59, pika 8 të Ligjit 80/2015; Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018 "Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë"; dhe nenin 31 të Rregullores për veprimtarinë mësimore, UNIKO respekton detyrimet për të siguruar që personeli akademik i angazhuar në mbulimin programit të studimit të jetë në përputhje nivelin e duhur të kualifikimit (me përjashtim të një rasti të evidentuar tek kriteri 2 i këtij standardi) dhe të respektojë kërkesat për ngarkesën mësimore, siç pasqyrohet edhe në syllabuset e lëndëve të këtij programi.</p> <p><i>Evidencat: [Ligj Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Shtojca 1.1 Statuti i UK; Shtojca 1.2 Rregullorja e UNIKO; Shtojca 2.26 Të dhëna për personelin akademik të departamentit Financë-Kontabilitet; Shtojca 2.5 Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave në Financë"; Shtojca 4.4 Kualifikimi dhe kerkimi shkencor të dhëna mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore të Departamentit Financë-Kontabilitet;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për administrimin e të dhënave, të kontratave individuale të punës të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ është Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore. Kopjet e kontratave individuale të punës si edhe monitorimi i afateve të kontratave për punonjësit e institucionit administrohen nga kjo drejtori, në përputhje me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, Rregulloren e UNIKO për mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave personale, si dhe me Rregulloren për Organizimin dhe Funkcionimin e Drejtorisë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore dhe respektivisht nenit 4 pika d, dhe nenit 7 pika 8. Baza e të dhënave përfshin dosjen personale të stafit akademik, organikën e FE, CV-në e personelit akademik dhe atij ndihmës akademik dhe administrativ, marrëveshën e organizimit të kohës vjetore, formularët për ngarkesën mësimore brenda dhe jashtë auditorit, syllabuset, regjistrin e pedagogut, dhe dokumente të tjera që janë të parashikuara në Kreun 1, pika 3 të udhëzimit.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p><i>Evidenca: [Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", i miratuar me Urdhërin nr. 22, datë 24.01.2022, të MAS; Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO; Shtojca 1.13 Udhëzimi për rekrutimin e stafit akademik; Shtojca 1.4 Rregullorja e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore; Shtojca 3.15 Kriteret, procedurat e shpalljes dhe ngritjes së komisionit të rekrutimit të stafit; Shtojca 1.2 Rregullorja e UNIKO; LIGJ Nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"; Shtojca 1.9 Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale; Shtojca 1.4 Rregullorja e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore; Shtojca 1.14 Udhëzimi për përmbajtjen e dosjes së stafit; Shtojca 2.33 Model dokumenti për organizimin e kohës vjetore të punës; Shtojca 3.32 Formular i ngarkesës të orëve; Shtojca 2.12 Model programi lëndor; Shtojca 4.9 Format i regjistrit të pedagogut; Shtojca 1.4 Rregullorja e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore; Shtojca 2.25 Organika e Fakultetit të Ekonomisë; Shtojca 2.9 Jetëshkrimet e stafit akademik të përfshirë në</i></p>

	<i>programin e studimit; Shtojca 3.24 Jetëshkrimet e stafit ndihmësimor dhe administrativ; Link 5.10 Organograma e UNIKO https://unkorce.edu.al/?s=organograma&post_type=post;]</i>			
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Referuar RVB dhe evidencave respektive, UNIKO në bashkëpunim me institucione financiare, biznese, apo institucione publike arrin të sigurojë personel të kualifikuar për të udhëhequr, instruktuar dhe mbikëqyrur studentët gjatë praktikës profesionale, punimit të diplomës dhe aktiviteteve të tjera të natyrës së programit të studimit. Sjellim në vëmendje se numri i studentëve në këtë program studimi është shumë i ulët (<i>mesatarisht më pak se 10 studentë në vit</i>) dhe si rrjedhim nuk ka vështirësi dhe mungesë kapacitetesh për t'iu përgjigjur kërkesave të tyre sipas nenit 38 të rregullores së brendshme të FE dhe nenit 20 të rregullores së Departamentit të Financë-Kontabilitetit. <i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"; Shtojca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të zhvillimit të praktikave profesionale; Shtojca 2.29 Komisionet e mbikqyrjes së praktikës; Shtojca 2.30 Pedagogët udhëheqës të temave të diplomës; Shtojca 4.10 Udhëzuesi i praktikës.]</i>			
Kriteri 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Bazuar në marrëveshjet e nënshkuara mes palëve, ofrohet mundësia për studentët që të përfitojnë nga përvoja dhe njohuritë e profesionistëve, duke përmirësuar përgatitjen e tyre për tregun e punës. Sipas RVB dhe përgjigjeve të marra gjatë vizitës në IAL, personeli mbikqyrës në ambientet e praktikës profesionale, që angazhohet në kuadër të këtyre marrëveshjeve, ndihmon studentët në përmbushjen e raportit të praktikës dhe merr pjesë në procesin e vlerësimit të tyre përmes plotësimit të Formularit të Vlerësimit të Studentit Praktikant. <i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"; Shtojca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të zhvillimit të praktikave profesionale; Shtojca 2.29 Komisionet e mbikqyrjes së praktikës; Shtojca 2.30 Pedagogët udhëheqës të temave të diplomës; Shtojca 4.10 Udhëzuesi i praktikës.]</i>			
Konkluzione	<i>GVJ në përfundim konkludon se programi i studimit ka qëndrueshmëri në personelin akademik të angazhuar, për të gjithë periudhën e akreditimit me kontrata pa afat të punësimit dhe shlyerjen e detyrimeve, por në stafin akademik të angazhuar ka të përfshirë edhe 1 PAE që nuk zotëron gradë shkencore, kjo është në kundërshtim me kuadrin ligjor e rregullator. Gjithashtu, pavarësisht se stafi akademik ka disa artikuj të publikuar në revista shkencore të indeksuara, këshillohet që stafi akademik të ketë më shumë angazhim në drejtim të publikimit të artikujve me faktor impakti si edhe eksperiencë aplikative përsa mund të afrojnë rajoni Korçës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

43

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Nga vizita në IAL, evidentohet qartë se UNIKO është rikonstruktuar dhe ofron mjedise të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Studentët e programit MSC në “Financë” kanë akses në një infrastrukturë të plotë, që përfshin ambiente mësimore, didaktike dhe logjistike të përshtatshme për realizimin e procesit mësimor, duke përbushur standardet e kërkuara, e konfirmuar kjo edhe nga raporti MAS. Për zhvillimin e mësimin teorik dhe praktik, janë të disponueshme salla mësimore me hapësira të mjaftueshme (pasi numri i studentëve ishte shumë i ulët në këtë program studimi për periudhën që vlerësojmë) dhe pajisje audiovizuale moderne.</p> <p><i>Evidencat: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 “RVB e MSC Financë”; Shtojca 1.15 Raporti i kontrollit të kapaciteteve pritëse të UNIKO; Shtojca 4.5 Tabela e të dhënave infrastrukturore në funksion të programit të studimit; Shtojca 3.37 Rikonstrukcioni i Godinës së Fakultetit të Ekonomisë;]</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Ndërtesa ku zhvillohet ky program studimi si edhe ushtron veprimtarinë njësjia bazë e ajo kryesore quhet “Godina e Fakultetit të Ekonomisë”. Kjo ndërtesë ka kaluar në rikonstrukcion të plotë, me qëllimin e krijimit të kushteve sa më bashkëkohore për studentët, si dhe për stafin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ. Nga GVB gjatë vizitës u konstatua se sallat e leksioneve janë të pajisura me teknologji të avancuar dhe mundësojnë realizimin e mësimin duke përdorur metoda moderne të mësimdhënies. Këto pajisje mund të përdoren gjithashtu nga studentët për prezantimin e detyrave të kursit, projekteve të praktikës profesionale dhe temave të diplomës.</p> <p><i>Evidencat: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 “RVB e MSC Financë”; Shtojca 4.5 Tabela e të dhënave infrastrukturore në funksion të programit të studimit; Shtojca 3.38 Projekti fitues “Avantazhet dhe sfidat e zbatimit të vendimmarrjes së mbështetur në të dhënat (Data-driven decision making) për bizneset dhe institucionet publike për Rajonin e Korçës”]</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Nga vet fusha e këtij programi studimi nuk kërkohen studio dhe atelie, por laboratorë në të cilët u evidentuan se kanë disa programe studimi për përpunim të dhënash, megjithatë nga komunikimi me studentët nuk u evidentua se ata kishin të instaluar dhe kryeni klasa studimore e aplikative me programe profesionale sipas natyrës së këtij programi studimi (si psh: programe kontabiliteti e finance të aplikuara në Shqipëri të tilla si Financa 5 dhe ALPHA, etj.)</p> <p><i>Evidencat: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 “RVB e MSC Financë”; Shtojca 4.5 Tabela e të dhënave infrastrukturore në funksion të programit të studimit; Shtojca 3.38 Projekti fitues “Avantazhet dhe sfidat e zbatimit</i></p>

	<i>të vendimmarrjes së mbështetur në të dhënat (Data-driven decision making) për bizneset dhe institucionet publike për Rajonin e Korçës”]</i>		
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Në ambjentet e mësimdhënies për programin e studimit gjendej një laborator i teknologjisë së informacionit, si edhe një laborator tjetër i fituar përmes një projekti kombëtar. Megjithatë nuk u evidentuan të ishin të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit. <i>Evidencat: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 “RVB e MSC Financë”; Shtojca 4.5 Tabela e të dhënave infrastrukturore në funksion të programit të studimit; Shtojca 3.38 Projekti fitues “Avantazhet dhe sfidat e zbatimit të vendimmarrjes së mbështetur në të dhënat (Data-driven decision making) për bizneset dhe institucionet publike për Rajonin e Korçës”]</i>		
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Për realizimin e praktikave mësimore, Departamenti i Financë-Kontabilitetit ka nënshkruar marrëveshje me biznese private, institucione dhe studio kontabiliteti, ku studentët mund të shohin dhe aplikojnë njohuritë që kanë fituar në kurse dhe module të ndryshme. GVJ vlerëson se për numrin e kufizuar të studentëve në këtë program studimi (më pak se 10 studentë), janë të mjaftueshme marrëveshjet për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. <i>Evidencat: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 “RVB e MSC Financë”; Shtojca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale]</i>		
Konkluzione	<i>GVJ për këtë standard nuk ka gjetje materiale të evidentuara, përveçse këshillimit për të pajisur laboratin me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen	Ambjentet e bibliotekës ishin të mirëmbajtura, por literatura në dispozicion për studentët ishte e pamjaftueshme dhe mungonte literatura bazë, qoftë edhe në versionin e ciklit të leksioneve në formatin fizik.

<p>e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB-së, UNIKO ofron akses në Bibliotekën Shkencore për të gjithë personelin akademik dhe studentët e fakulteteve, ku ndodhen 4071 libra dhe 1265 tituj. Ndërsa biblioteka e Fakultetit të Ekonomisë kishte një fond prej 5316 librash dhe 3610 titujsh, ku librat janë të disponueshëm si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhë të huaja. Konkretisht, ka 226 libra në shqip dhe 5090 libra në gjuhë të huaja.</p> <p><i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"; Shtojca 4.6 Raport për fondin e librave dhe infrastrukturën e bibliotekave në UNIKO; Shtojca 4.7 Raport për fondin e librave të bibliotekës në FE;]</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>UNIKO ka marrë masa për të rritur fondin e bibliotekës në përputhje me Urdhërin Nr.39 datë 25.01.2019 të rektorit të universitetit ose përmes donacioneve të ndryshme, duke iu përgjigjur kërkesave të pedagogëve, nevojave të njësive bazë, gjendjes së bibliotekës, kërkesave të studentëve dhe të komunitetit, gjithashtu duke marrë parasysh buxhetin e miratuar për Fakultetin e Ekonomisë. Megjithatë, për programin e studimit që vlerësojmë, gjendja për literaturën e kërkuar paraqitet si në përgjigjen e dhënë në kriterin 1.</p> <p><i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"; Shtojca 4.11 Urdhri Nr.39 datë 25.01.2019 të rektorit të UNIKO; Shtojca 4.6 Raport për fondin e librave dhe infrastrukturën e bibliotekave në UNIKO; Shtojca 4.7 Raport për fondin e librave të bibliotekës në FE]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka shërben si sallë studimi dhe është e pajisur me 4 kompjutera, internet dhe sistem ngrohje, duke siguruar kushte komode për studentët për lexim dhe studim. Studentët jo vetëm që mund të huazojnë libra (pa pagesë), por mund të përdorin gjithashtu ambientet për studim. Biblioteka Shkencore pranë Rektoratit përdoret edhe nga komuniteti.</p> <p><i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"; Shtojca 4.6 Raport për fondin e librave dhe infrastrukturën e bibliotekave në UNIKO; Shtojca 4.7 Raport për fondin e librave të bibliotekës në FE]</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB-së, UNIKO ka krijuar mundësinë për staf akademik dhe studentë të përdorin Bibliotekën Online, si pjesë e projektit për digjitalizimin e bibliotekës, i cili është një nga objektivat e Planit Strategjik të Universitetit 2022-2027. Ky shërbim ofron mundësinë për të lexuar dhe shkarkuar tekste pa pagesë, përmes një adrese email dhe password të bibliotekës online, U-Library. Aksesimi është i lehtë dhe mund të bëhet përmes faqes zyrtare të universitetit, ku të gjithë përdoruesit regjistrohen me adresën e tyre zyrtare. Ky shërbim ofron mbi 170,000 libra, 70 milion artikuj akademikë, artikuj gazetash, hartat dhe mjete audiovizive.</p> <p><i>Evidencat: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"; Shtojca 4.7 Raport për fondin e librave të bibliotekës në FE; Shtojca 1.3 Plani Strategjik për Zhvillimin e Universitetit 2022-2027; Shtojca 3.39 dhe video tutorial për qasjen e bibliotekës online https://www.youtube.com/watch?v=p1E_asNRKJo;]</i></p>

<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Pranë godinës së FE, salla e bibliotekës shërbente si sallë studimi dhe sigururonte kushte komode për studentët për lexim dhe studim. Nga bisedat me studentët, evidentohet se mund të huazonin librat pa pagesë, ose mund të përdornin gjithashtu ambientet për studim.</p> <p><i>Evidencat: [Shtojca 4.7 Raport për fondin e librave të bibliotekës në FE;]</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Referuar RVB-së, bibliotekat janë të pajisura me mjete kompjuterike e fotokopje duke përfshirë gjithsej 45 kompjuterë. Konkretisht, Biblioteka Shkencore ka 6 kompjuterë, Fakulteti i Ekonomisë 4 kompjuterë, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë 11 kompjuterë, ndërsa Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane disponon 28 kompjuterë. <i>Të gjitha këto mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët si edhe komunitetin jashtë UNIKO.</i></p> <p><i>Evidencat: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"; Shtojca 4.6 Raport për fondin e librave dhe infrastrukturën e bibliotekave në UNIKO; Shtojca 4.7 Raport për fondin e librave të bibliotekës në FE;]</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka pranë Fakultetit të Ekonomisë ka një orar funksionimi prej orës 8:00 deri në 16:00, nga e hëna në të premte. Përdorimi i bibliotekës është i mundur vetëm me kartela të regjistrimit. Studentët dhe pedagogët kanë kartela personale, dhe gjithashtu edhe personeli akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe komuniteti mund të bëhen anëtarë të bibliotekës universitare. Megjithatë, GVJ këshillon të shikohet mundësia e zgjatjes së orarit të bibliotekës edhe në oraret e pasdites e lidhur kjo edhe me këshillimin për zhvillimin e mësimin në pasdite për programet master.</p> <p><i>Evidencat: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"]</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>GVJ referuar RVB-së nuk evidentoi informacion dhe evidenca relevante në përgjigje të këtij kriteri. Mungesat në bibliotekë evidentohen si edhe më sipër për këtë program studimi.</p> <p><i>Evidencat: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"]</i></p>

Konkluzione	<i>GVJ në përfundim evidenton se: ka mungesa të literaturës bazë, qoftë edhe në versionin e ciklit të leksioneve në formatin fizik për programin e studimit, si edhe vlerëson si praktikë pozitive për tu përqaftuar edhe nga IAL të tjera, hapja e bibliotekës në përdorim të komunitetit jashtë IAL-së.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Referuar RVB-së, evidentohet se UNIKO ka në dispozicion sisteme të integruara informacioni, të cilat funksionojnë si pjesë e projektit RASH. Ky është një sistem menaxhimi gjithëpërfshirës i informacionit, duke mundësuar mbledhjen e të dhënave, si ato për menaxhimin e mësimdhënies, studentëve, kërkimit, burimeve njerëzore, etj. Të gjithë informacionet për studentët dhe aktivitetet e tyre menaxhohen përmes sistemit PITAGORA, i cili ofron një sekretari elektronik të plotë. Gjithashtu, PITAGORA menaxhon dokumentacionin lidhur me vlerësimin e studentëve. Pjesa tjetër e dokumentacionit përfshin dhe regjistrat e pedagogëve, të cilat kontrollohen nga përgjegjësi i departamentit dhe nga ekipi i punës i ngritur nga Rektorati çdo vit akademik. Ky sistem përdoret nga studentët, pedagogët dhe sekretarët dhe ka integruar gjithashtu një sistem të pagesave me bankë për tarifën dhe pagesat për shërbime. Për çdo përdorues është hartuar një udhëzues për përdorimin e modulit përkatës. Sistemi PITAGORA siguron akses të dedikuar dhe është i mbrojtur nga ndërhyrjet e paautorizuara. Sistemi gjithashtu mundëson monitorimin e aktiviteteve akademike dhe administrative nga drejtuesit dhe titullarët e institucionit përmes raporteve që krijohen automatikisht. Gjithashtu, platforma që mundësojnë përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe komunikimit interaktiv përfshijnë: <i>Aplikacionin Moodle</i> . Aplikacioni tjetër, ku përmendim ato përmes Paketës "Office 365 for Education" që mund të sigurojnë mundësi për stafin dhe studentët të përdorin dhe të kenë akses në platformat më të avancuara për mësimdhënie dhe komunikim online, në çdo kohë dhe vend përmes internetit. Megjithatë GVJ nuk konstaton në RVB apo gjatë vizitës të paraqiten evidencat për adresimin e rekomandimeve të KLSH për marrjen e masave për adresimin e gjetjeve sipas raportit përfundimtar të auditimit (2023): "IAL-të duke mos e njohur Rezolutën 2001/C 204/02, e njohur si Rezoluta mbi E-Learning e miratuar nga Këshilli i Ministrave të vendeve anëtare të BE-së.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton	<i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"; Shtojca 1.6.1 Manual i sistemit elektronik PITAGORA; Shtojca 1.6</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

48

monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	<i>Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik PITAGORA; Linkun për manualin e përdorimit të librarisë elektronike gjendet në https://unkorce.edu.al/archive/bibliotekat/shk/; Linku për aplikacionin që mundëson komunikimin interaktiv https://unkorce.edu.al/lms-2/; Shtojca 4.12 Rezultatet e auditit;]</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Referuar vizitës në IAL dhe kontrollit të website zyrtar të UNIKO, konstatohet se për informacion mbi programin "Master i Shkencave në Financë" në faqen zyrtare të internetit të UNIKO (https://unkorce.edu.al/) gjendet plani mësimor dhe skeda e programit në gjuhën shqipe. Sipas konstatimit të GVJ, në faqen e internetit të UNIKO nuk ka publikim të informacionit në gjuhën angleze, duke rezultuar me këtë kriter të pa plotësuar. <i>Evidencë: [Vizita në IAL dhe verifikimi website nga GVJ, website i UNIKO jepet në https://unkorce.edu.al/.]</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se se nuk gjen të evidentuar me fakte nëse UNIKO e ka adresuar rekomandimin e dhënë nga KLSH për marrjen e masave për adresimin e gjetjeve sipas raportit përfundimtar të auditimit (2023): "IAL-të duke mos e njohur Rezolutën 2001/C 204/02, e njohur si Rezoluta mbi E-Learning e miratuar nga Këshilli i Ministrave të vendeve anëtare të BE-së...dëshmojnë se kanë mangësi lidhur me informacionin që lidhet me praktikat e e-learning...". Vlerësojmë pozitivisht punën e bërë nga NJSBC pranë UNIKO e cila evidenton këtë mos plotësim në raportet e saj, duke u shprehur për nevojat për përmirësim në këtë drejtim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Sipas RVB-së, bazuar në nenin 84, të statutit të UNIKO hartimi i buxhetit të UNIKO fillon nga njësi bazë, Departamenti Financë-Kontabilitet për këtë program studimi. Në këtë fazë, merren parasysh nevojat financiare për mbarëvajtjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi. Administrata e Universitetit, harton projekt buxhetin e njësisë të tjera ndihmëse dhe së bashku me projekt buxhetin e njësisë kryesore, harton projekt buxhetin e vitit respektiv. Gjithashtu, burimet financiare shpërndahen dhe përdoren sipas strukturës së Buxhetit të Shtetit dhe realizohet në dy faza, hartimin dhe miratimin e

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>buxhetit nga granti i pakushtëzuar që akordohet nga MAS dhe buxhetin nga të ardhurat e Universitetit bazuar në nenin 78 të statutit të UNIKO.</p> <p>Në gjysmën e dytë të çdo viti, bazuar në nenin 77 të statutit, UNIKO kryen procedurat për miratimin e projekt buxhetit afatmesëm, i cili mbështetet tek kërkesat e njësisë kryesore dhe ndihmëse, për të cilin ndiqet e njëjta procedurë si edhe për hartimin dhe miratimin e buxhetit vjetor. Bordi i Administratës siguron qëndrueshmërinë financiare të UNIKO, sipas statutit të universitetit. Miratimi i buxhetit afatmesëm për tre vjet dhe burimet e tij, si tarifat e studentëve dhe granti i pakushtëzuar nga MAS, janë indikatorë të qëndrueshmërisë financiare të universitetit. UNIKO harton një plan financiar që përfshin ndarjen e burimeve financiare sipas kategorive të ndryshme, si financimi i burimeve njerëzore (paga dhe shpërblime), shpenzimet operative për mirëmbajtjen e ambienteve dhe pasurimin e literaturës.</p> <p>GVJ bazuar në evidencat e dorëzuar konstaton se kosto mesatare për student "Grant i Buxhetit të Shtetit" ka një tendencë rritje të dukshme për çdo vit akademik. Sipas RVB-së, nuk evidentohet nëse UNIKO harton një plan financiar të dedikuar për këtë program studimi. Në përfundim, GVJ konkludon se pavarësisht se UNIKO është një IAL publike, hartimi dhe miratimi i buxhetit të Universitetit duhet të mbështetet mbi analizën e kostos për student për çdo program studimi</p> <p><i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"; Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO; Shtojca 3.10 Kosto mesatare për student; Shtojca</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Evidentojmë se GVB shprehet se UNIKO respekton ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, dhe çdo vit dorëzon pasqyrat financiare pranë MAS dhe Degës së Thesarit të Korçës. Universiteti i nënshtrohet auditimit financiar nga Auditi i Brendshëm i MAS dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit, dhe rezultatet e auditimit publikohen në faqen zyrtare të universitetit dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Raporti i aktivitetit financiar diskutohet me organet kolegjiale të universitetit, përfshirë Rektoriatin, Bordin e Administrimit dhe Senatit Akademik, dhe është i disponueshëm për gjithë personelin dhe studentët e interesuar.</p> <p><i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"; Shtojca 4.12 Rezultatet e auditit;]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Referuar RVB, shpërndarja e burimeve bëhet në përputhje me strukturën e Buxhetit të Shtetit dhe realizohet në dy faza: hartimi dhe miratimi i buxhetit nga granti i pakushtëzuar i MAS dhe buxheti nga të ardhurat e universitetit. Gjatë gjysmës së dytë të çdo viti, Universiteti fillon procedurat për hartimin e projektbuxhetit afatmesëm, bazuar në kërkesat e njësisë kryesore dhe ndihmëse, dhe ndjek të njëjtën procedurë si për buxhetin vjetor. Ky plan përcakton prioritetet për investimet gjatë tre viteve të ardhshme në përputhje me nevojat infrastrukturore dhe logjistike. Burime të tjera financimi por me kontribut modest për shpenzimet e UNIKO janë: pagesat nga</p>

	<p>studentët, të ardhurat nga shërbimet, marrëdhëniet me palët e treta, donacione dhe burime të tjera ligjore, si dhe të ardhurat nga aktivitetet kërkimore-shkencore.</p> <p><i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"; Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO; Shtojca 3.42 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në tre vitet e fundit.]</i></p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Referuar RVB, përgatitja e buxhetit të UNIKO fillon nga njësitë bazë, duke ju bërë atyre thirrje të dërgojnë nevojat financiare për zhvillimin e programeve të studimit për një cikël të plotë të tyre. Po kështu vepron edhe Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit për parashikimin e nevojave për buxhet dhe këto ja propozon Dekanatit për të vijuar më sipër. Administrata e Universitetit përgatit projektbuxhetin dhe merr miratimet e nevojshme për buxhetin e vitit përkatës dhe financimin e tyre nga buxheti i shtetit. Menaxhimi i shpenzimeve bëhet nga njësi e caktuar në varësi të Rektoratit, e cila kujdeset që kërkesat e çdo njësie bazë të plotësohen sipas parashikimeve. Gjithashtu, në fund të çdo cikli të studimit, universiteti dokumenton të ardhurat dhe financimet për tre vitet akademike të kaluara për të bërë planifikimin e shpenzimeve dhe përbushjen e objektivave strategjike të institucionit.</p> <p><i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"; Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO; Shtojca 3.42 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në tre vitet e fundit.]</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konkludon se kosto mesatare për student "Grant i Buxhetit të Shtetit" ka një tendencë rritje. Në përfundim, GVJ konkludon se pavarësisht se UNIKO është një IAL publike, hartimi dhe miratimi i buxhetit të Universitetit duhet të mbështetet mbi analizën e kostos për student për çdo program studimi me qëllim kryerjen e analizave të nevojshme për mirëmenaxhimin e fondeve të marra nga buxheti i shtetit dhe orientimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturën e UNIKO në arritjen e misionit të tij përmes analizës dhe përcaktimit të strategjive konkrete për çdo njësi bazë dhe program studimi.</i></p>								
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

51

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Sipas statutit të UNIKO bazuar dhe në dispozitat e Ligjit 80/2015, UNIKO ka përcaktuar procedurat dhe politikat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve të këtij programi nga hyrja në dalje të tyre. Rregullore e Brendshme e Fakultetit Ekonomik specifikohen gjithashtu rregullat e regjistrimit të studentëve, hartimit të planeve mësimore, struktura e vitit akademik, zhvillimit të provimeve, përgatitjes dhe shpërndarjes së diplomave etj. Gjithashtu, sipas rregullores së programit të studimit e mbështetur në kërkesat e ligjit 80/2015 përcaktohen gjithashtu edhe procedurat e tërheqjes së diplomës.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB, evidentojmë një seri dokumentesh të përfshira në aktet rregullatore të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë (shkurt UNIKO) mbulojnë të gjithë ciklin akademik të studentëve, duke nisur nga pranimi deri te diplomimi, në përputhje me ligjin në fuqi. Këto dokumente përfshijnë: Statutin e UNIKO (Kreu VI, Nenet 51-52, 56-57, 65-72), Rregulloren e UNIKO (Kreu VI, Nenet 47-48, 57, 59-60, 62-70, 72-74; Kreu VII, Nenet 76-99), Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Ekonomisë (Kreu IV, Nenet 29-30; Kreu VI, Nenet 42-49; Kreu VIII, Nenet 63-67), Rregulloren e Brendshme të Departamentit të Financë-Kontabilitetit (Kreu IV, Nenet 15-16; Kreu VI, Nenet 23-27; Kreu VII, Nenet 28-29; Kreu VIII, Nenet 31-34), Rregulloren e Programit të Studimit për Master në "Financë" (seksioni 8), dhe Manualin e Sistemit PITAGORA, i cili reflekton kërkesat për përdorimin e sistemit të informacionit Pitagora nga UNIKO.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Këto procedura dhe politika sigurojnë mundësi të barabarta dhe të drejta për të gjithë kandidatët dhe studentët e programeve të studimit. Ky aspekt është shprehur qartë në Rregulloren e Programit të Studimit për Master në "Financë" (seksioni 10), ku flitet për shkeljet e integritetit akademik.</p> <p>Dokumentet përkatëse për pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve, përparimin gjatë programit të studimit, transferimin e krediteve dhe njohjen e studimeve të mëparshme janë paraqitur në mënyrë të qartë për të qenë të kuptueshme për studentët dhe palët e tjera të interesuara. Këto informacione janë të disponueshme në faqen zyrtare të internetit të UNIKO, duke i bërë ato të aksesueshme për të gjithë të interesuarit.</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit për gjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë</p>	<p>Sipas Rregullores së Brendshme të Departamentit të Financë-Kontabilitetit (Kreu II, Neni 5), ky departament propozon kriteret e pranimit të studentëve për çdo program studimi. Kriteret e pranimit për çdo vit akademik përgatiten dhe miratohen nga Drejtoria e Fakultetit të Ekonomisë dhe më pas paraqiten për miratim në Senatit Akademik. Pas miratimit, këto kriteret i dorëzohen ministrisë përgjegjëse për arsimin. Këto kriteret bëhen publike dhe shpjegohen për të informuar sa më mirë të gjithë të interesuarit.</p>

lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	GVJ gjatë vizitës në sekretarinë e IAL-së u bë me dije se regjistrimi i studentëve në programin e studimeit MSC në “Financë” kryhej pranë tyre duke respektuar renditjen sipas listave të publikuara të studentëve fitues duke garantuar barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student. Për tu evidentuar është edhe konstatimi i kryer në verifikim e bërë në web të UNIKO ku gjenden të publikuara të gjitha kriteret dhe procedurat që kanë të bëjnë me: pranimin, përzgjedhjen e studentëve, përparimin përgjatë kursit të studimit, transferimin, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit për cilindo prej studentëve që ndjek këtë program studimi.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Përpara çdo viti akademik, UNIKO harton dhe publikon kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, grupe të pakicave, shtresave të marginalizuara dhe studentëve nga shtete të tjera, në përputhje me Udhëzimin Nr. 10, datë 15.05.2019.
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	<i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 “RVB e MSC Financë”; Shtojca 1.1 Statuti i UK; Shtojca 1.2 Rregullorja e UNIKO; Shtojca 2.2 Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë; Shtojca 2.3 Rregullore e Brendshme e Departamentit të Financë-Kontabilitetit; Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit “Master i Shkencave” në “Financë”; Shtojca 1.6.1 Manual i Sistemit elektronik PITAGORA; Shtojca 2.22 Kriteret e Pranimit në Programin e Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Financë për periudhën 2023-2024, 2024-2025; Shtojca 2.23 Për Vlerësimin dhe Ekuivalentimin e Dosjeve të Kandidatëve për Transferim Studimesh dhe për Program të Dytë Studimi”; Shtojca 4.12 Rezultatet e auditit;]</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Po ashtu, UNIKO ka politika për mbështetje financiare për studentët që ndodhen në nevojë dhe ofron përparësi për ata që kontribuojnë në zhvillimin e programit dhe të ekonomisë kombëtare, në përputhje me Vendimin Nr. 780, datë 26.12.2018. Shtojca 4.13 ofron informacion të detajuar për studentët që kanë përfutuar mbështetje financiare gjatë programit të studimit. Por në mbështetje të rekomandimeve të dhëna nga KLSH në raportin e saj (raporti përfundimtar i auditimit (2023), GVJ nuk gjen referenca të evidentuar në RVB nëse UNIKO i ka adresuar rekomandimet e dhëna: (“UNIKO ka marrë masa për të rifreskuar marrëveshjet e bashkëpunimit me njësitë e vetqeverisjes vendore si edhe operatorë privatë për të mundësuar shërbime me çmime të reduktuara për studentët”; “UNIKO në kuadrin e marrëveshjeve me njësitë e qeverisjes vendore, të parashkruhen tërësia e tarifave lehtësuese për studentët, me qëllim për ta bërë efçente kartën e studentit në nivel rajonal”)
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 “RVB e MSC Financë”; Shtojca 4.12 Rezultatet e auditit; Shtojca 4.13 Mbështetja financiare gjatë programit të studimit Master në “Financë”.]</i>

Konkluzione	<p>GVJ konkludon se përveç kujdesit të treguar nga IAL për këtë standard, gjykon se nuk ka vend për risk material në këto kritere të trajtuara në këtë standard përderisa jemi në kushtet dhe rrethanat kur ky program studimi në këto vitet e fundit nuk ka arritur të plotësoj kuotat e miratuara. Por, gjithashtu, GVJ nuk gjen referenca të evidentuar në RVB nëse UNIKO e ka adresuar rekomandimin e dhënë nga KLSH sipas raportit përfundimtar të auditimit (2023) ku UNIKO është angazhuar se:</p> <p>“UNIKO ka marrë masa për të rifreskuar marrëveshjet e bashkëpunimit me njësitë e vetqeverisjes vendore si edhe operatorë privatë për të mundësuar shërbime me çmime të reduktuara për studentët”;</p> <p>“UNIKO në kuadrin e marrëveshjeve me njësitë e qeverisjes vendore, të parashkruhen tërësia e tarifave lehtësuese për studentët, me qëllim për ta bërë efçente kartën e studentit në nivel rajonal”.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Referuar RVB, evidentojmë se studentët e këtij programi studimi mund të sigurojnë informacion të plotë dhe të detajuar mbi përparimin e tyre akademik, njohjen dhe vlerësimin e dijeve deri në përfundimin e studimeve dhe diplomimit. Të gjitha këto bazuar në Statutin e UNIKO, Kreu VI, Nenet 67-72, Rregullorën e UNIKO, Kreu VI, Nenet 43, 47-48, 57, 59-73, Kreu VII, Nenet 76-100, Rregullorën e Brendshme të Fakultetit të Ekonomisë, Kreu IV, Nenet 29-30, Kreu VI, Nenet 42-49, Kreu VIII, Nenet 63-67, Kreu IX, Nenet 68-73, Kreu X, Nenet 75-87, Kreu XI, Nenet 88-96, Kreu XII, Nenet 97-102, Rregullorën e Brendshme të Departamentit të Financë-Kontabilitetit, Kreu IV, Nenet 15-16, Kreu VI, Nenet 23-27, Kreu VII, Nenet 28-29, Kreu VIII, Nenet 31-34, Kreu IX, Nenet 35-36, Kreu X, Nenet 37-40, dhe Rregullorën e Programit të Studimit “Master i Shkencave” në “Financë” bashkë me Shtojcat përkatëse.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Informacioni i detajuar lidhur me diplomimin e studentëve të këtij programi mund të gjendet në Rregulloren e Programit të Studimit “Master i Shkencave” në “Financë”, seksioni 7, i cili trajton Diplomimin/Modalitetin për dhënien e diplomës. Studentët kanë gjithashtu në dispozicion Udhëzuesin për Punimin e Diplomës (Shtojca 4 e kësaj Rregulloreje), që përfshin udhëzime mbi mënyrën e strukturimit dhe formatimit të punimit të diplomës.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe	

diplomimit në programin e studimit.	Nga verifikimet e kryera nga GVJ, në faqen web të Universitetit gjendet gjithashtu një hapësirë e dedikuar për studentët në të cilën marrin informacion në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve, etj.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Ky informacion u ofrohet studentëve përmes disa kanaleve, siç është shpjeguar në Rregulloren e njësisë kryesore, Kreu XV, Neni 114. Për informimin e studentëve të ardhshëm dhe të interesuarve të tjerë rreth programit të studimit, Rregullorja e Programit të Studimit “Master i Shkencave” në Financë ka rol udhëzues. Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA) harton dhe shpërndan fletëpalosje informuese për studentët e ardhshëm dhe organizon takime informuese me ta, siç përmendet në Rregulloren e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional, Kreu III, Neni 9, pika 3, dhe Neni 10, pika 11-12. Një analizë e plotë e veprimtarisë së QKA paraqitet në dokumentin e Analizës së Veprimtarisë për vitin akademik përkatës. <i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 “RVB e MSC Financë”; Shtojca 4.13 Të Dhëna mbi Studentët e Programit të Studimit Master i Shkenace në Financë që Kanë Përfutur Mbështetje Financiare, 2020-2023; Shtojca 3.27 Fletëpalosje Informuese rreth Programeve të Studimit të Ofruar nga FE; Shtojca 3.20 Analiza e Veprimtarisë së Qendrës së Karrierës dhe Alumni 2022-2023.]</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se studentët e këtij programi studimi mund të sigurojnë informacion të plotë dhe të detajuar mbi përparimin e tyre akademik, njohjen dhe vlerësimin e dijeve deri në përfundimin e studimeve dhe diplomimin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Rregullorja e Programit të Studimit “Master i Shkencave” në “Financë”, së bashku me Shtojcat përkatëse, ofron informacion të detajuar dhe të plotë për objektivat formues, strukturën, organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit, si dhe për rezultatet që priten nga procesi i të nxënit dhe mundësitë e punësimit pas përfundimit të tij. Ky informacion u ofrohet studentëve përmes disa kanaleve, siç parashikohet në Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Ekonomisë, Kreu XV, Neni 114.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet,	

përbajtjen dhe veprimtarinë formuese.	UNIKO ka përfshirë në strukturën e tij organizative Qendrën e Karrierës dhe Alumni (QKA), e cila ofron mbështetje për studentët lidhur me mundësitë e punësimit. QKA i ndihmon studentët duke i trajnuar dhe orientuar ata për tregun e punës, duke përdorur informacionin që mbledh nga të dhënat e disponueshme, sipas Rregullores së Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional, Kreu III, Neni 9, pikat 6-7 dhe 10.			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Në fillim të çdo viti akademik ose semestri, Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financë-Kontabilitetit përgatisin dhe publikojnë: 1. Strukturën mësimore të programit të studimit dhe 2. Orarin e mësimin, siç kërkohet nga Rregullorja e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë, Kreu IX, Neni 69.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Informacioni rreth programit të studimit sigurohet përmes disa formave, siç shpjegohet në Rregulloren e Brendshme të Departamentit të Financë-Kontabilitetit, Kreu VII, Neni 29, dhe përmes sistemit të menaxhimit të informacionit PITAGORA, i cili shpjegohet në manualin e sistemit elektronik PITAGORA, në faqet 18-19. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet nga strukturat si: Sekretaria mësimore, QKA dhe stafit akademik. Megjithatë, GVJ bazuar në tabelat pjesë e RVB-së vlerëson se nuk është bërë mjaftueshëm duke konstatuar tregues të ulët në nivelin e punësimit të studentëve të diplomuar në këtë program studimi, ose mos njohje e treguesve të vërtetë e evidentuar kjo edhe gjatë vizitave në IAL.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"; Shtojca 4.8 Databaza e Punëdhënësve Aktivë: Tabela 23 "Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve]</i>			
Konkluzione	<i>Në përfundim lidhur me këtë standard, GVJ sjell në vëmendje të IAL-së se duhet gjetur mekanizmi nxitës që stafi akademik dhe zyrat përkatëse të jenë aktive dhe efikente në përfshirjen aktive të studentëve duke krijuar për ata mundësinë e marrjes së eksperiencave të para dhe më pas punësimin në profesion të tyre.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e	GVJ gjatë vizitës në IAL, kërkoi të verifikojë ato çfarë evidentoheshin në RVB, se sekretaria mësimore e DFK disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, numrin e studentëve

<p>studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>të regjistruar në programet e studimit, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimi me sukses i vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se të dhënat e cituara më sipër ruhen në formë të shkruar (hard copy) sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 71 të statutit të UK-ja i cili detyrohet të mbajë në formë të shkruar në bazë të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë":</p> <p>a) Regjistrin themeltar i studentëve të UNIKO. Ky është i plotësuar edhe në formë elektronike (Rregullore e Sekretarisë, neni 13);</p> <p>b) Regjistrin e arritjeve akademike për çdo student të regjistruar në UNIKO për këtë program studimi. Ky është i plotësuar edhe në formë elektronike;</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>c) Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave. Ky është i plotësuar edhe në formë elektronike;</p> <p>në përputhje me kërkesat e Rregullores së këtij sektori të UNIKO-së, Nenet 5-14. Neni 113 i Kreut XV të Rregullores së Brendshme të Fakultetit të Ekonomisë thekson ruajtjen e të dhënave personale të studentëve. Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik PITAGORA, në seksionin Studentët, faqe 21, dhe seksioni "Siguria e të dhënave: Konfidencialiteti, Integrimi, Vlefshmëria", shpjegon që ky sistem i brendshëm mundëson menaxhimin e të dhënave të studentëve që nga regjistrimi deri te diplomimi, duke siguruar mbrojtjen e të dhënave dhe mundësinë e verifikimit nga personat e autorizuar. Kjo është gjithashtu e specifikuar në Statutin e UNIKO, Kreu VIII, Neni 83.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>UNIKO siguron mbështetje përmes aktesh dhe kontrollon periodikisht njësitë përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave, duke vlerësuar dhe dokumentuar saktësinë e informacionit dhe dokumenteve që lidhen me studentët dhe aktivitetet e tyre. Kjo është përfshirë në Rregulloren e Sektorit të Studimeve dhe të Sektorit të TIK, Kreu II, Nenet 10, 11, 12.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>QKA duhet të mbledh të dhëna mbi punësimin e studentëve në përputhje me Rregulloren e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional, Kreu III, Neni 9, pika 7, Neni 10, pikat 4, 19, dhe ti përditësoj ato në databazat respektive. Ndërkohë të dhënat e raportuara në "Tabelën 23" nuk rezultojnë optimiste ose të jenë të sakta sipas kontestimeve të bëra gjatë vizitës në IAL.</p>
	<p><i>GVJ këshillon se të dhënat e punësimit të studentëve të këtij programi duhet të saktësohen dhe azhurnohen me frekuencë të paktën çdo 6 muaj, të përdoren nga UNIKO për përgatitjen e raporteve analitike periodike për këtë program studimi, të analizohen e përfshihen në Analizën Vjetore të Veprimtarisë së Fakultetit të Ekonomisë, si dhe në raporte të Departamentit të Financë-Kontabilitetit.</i></p>

	<i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"; Shtojca 1.6 Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik PITAGORA; Shtojca 1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe e Sektorit të TIK; Tabela 23 "Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve; Shtojca 1.9 Rregullore për Mbrojtjen, Ruajtjen dhe Përpunimin e të Dhënave Personale; Shtojca 3.9 Analiza Vjetore e Veprimtarisë së Fakultetit të Ekonomisë 2022-2023]</i>			
Konkluzione	<i>GVJ këshillon se të dhënat e punësimit të studentëve të diplomuar në këtë program studimi duhet të saktësohen dhe azhurnohen me frekuencë të paktën çdo 6 muaj, si edhe IAL duhet të bëjë më shumë për mbështetjen dhe gjurmimin e studentëve për punësimin e tyre, si dhe shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre qoftë edhe duke ofruar mundësinë e vijimit të kualifikimeve me kurse speciale që kërkon tregu i punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	UNIKO në zbatim të nenit 98 dhe 99 të Ligjit Nr. 80, 2015, dhe nenit 69 të Statutit të UNIKO, studentët kanë të drejtë, të zgjedhin dhe të zgjidhen si përfaqësues në organet vendimmarrëse të UK-së në nivele të Senatit (10%) dhe të komisioneve. Sipas RVB, Rektorati i UK-së mbështet kërkesat e Këshillit studentor duke marrë miratimin e Organeve Akademike dhe Administrative (në varësi të veprimatrive), në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me financimin, përfshirjen e tyre akademike ose me organizimin e veprimatrive studentore, këto mund të verifikohen në website të UNIKO. Të zgjedhin dhe të zgjidhen për Këshillin e Studentëve të njëjësive përkatëse, si dhe në atë në nivel institucional. Rregullorja e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë, Kreu XIV, Neni 108, po ashtu thekson të drejtën e studentëve për t'u organizuar në këshilla studentorë në nivel njësie, institucioni të arsimit të lartë, dhe në nivel kombëtar. Statuti i UK, Kreu III, Neni 18, pika 31 përcakton që Senati Akademik zgjedh anëtarët e Këshillit të Etikës dhe Komisioneve të Përhershme, ku përfaqësues të studentëve janë pjesë e tyre. Neni 29, pika 4 specifikon që 1 nga 7 anëtarët e Këshillit të Etikës është përfaqësues i studentëve.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Aktet rregullatore të brendshme të UNIKO dhe aktet ligjore të përkatshme mundësojnë pjesëmarrjen aktive të studentëve në proceset e vendimmarrjes dhe këshillimit në lidhje me zhvillimin, miratimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësinë e burimeve dhe shërbimeve që ofrohen për ta. Sipas RVB-së, para sezonit të provimeve nga studentët duhet të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

58

	<p>plotësohet pyetëtori për cilësinë e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve për modulet e çdo programi studimi. Por gjithashtu thuhet se pas analizës së rezultateve të pyetëtorit çdo pedagog merr në konsideratë ankesat apo edhe sugjerimet e studentëve për përmirësim të syllabusit dhe mënyrave të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 “RVB e MSC Financë”; Shtojca 1.18 Rregullorja për Organizimin e Zgjedhjeve në UNIKO; Shtojca 1.11 Rregullorja e Senatit Akademik; Shtojca 1.19 Kodi i Etikës së UNIKO; Lista e anëtarëve të Këshillit të Etikës, i Këshillit studentor të UK-së, Lista e anëtarëve të Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, dhe Lista e Anëtarëve të Bordit të Administrimit të UNIKO; Shtojca 1.20 Rregullorja e Bordit të Administrimit]</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Referuar GVB, statuti i UK, Kreu VIII, Neni 80, pika 2 sqaron se këshillat e studentëve promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinimin e përfaqësimit të tyre në organet drejtuese të UNIKO, ndërsa pika 7 e këtij neni përcakton që këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime mbi çështjet me interes të përgjithshëm për UNIKO, siç janë programet e studimit, cilësia e shërbimeve dhe shpërndarja e burimeve financiare. Statuti i UK, Kreu IX, Neni 73, pika 2 dhe Neni 85, pika 1 shpjegojnë se, në kuadër të sigurimit të cilësisë brendshme të UNIKO, brenda Sektorit të Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni funksionon Njësia e Sigurimit të Cilësisë, ku një anëtar është përfaqësues i studentëve. Ky grup vlerësimi është ngritur pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe çdo njësi tjetër, me përfaqësim nga çdo njësi dhe organizmat studentorë. Gjithashtu, sipas VKM nr. 782, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin në institucionet publike të arsimit të lartë” përcakton se një përfaqësues i studentëve merr pjesë në Bordin e Administrimit, organin më të lartë drejtues administrativ të UNIKO, sipas Statutit të UK, Kreu III, Neni 16, pika 4. Statuti i UK, Kreu IV, Neni 33 sqaron që Bordi i Administrimit përbëhet nga 7 anëtarë. Roli i Bordit të Administrimit është përmendur edhe në Rregulloren e UNIKO, Kreu IV, Neni 25. Ndërsa rregullorja e brendshme e Fakultetit të Ekonomisë, Kreu XIII, Neni 103, pika 2 siguron përfshirjen e studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies përmes plotësimit të pyetëtorit studentor në fund të çdo semestri, i cili menaxhohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). 1 nga 8 anëtarët e kësaj njësie është përfaqësues i studentëve, duke siguruar që mendimet e studentëve të reflektohen në analizën e pyetëtorit.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Ndërsa RVB citon se DFK për të siguruar barazi dhe ndershmëri të kryerjes së procesit të vlerësimit të studentëve përmes sistemit krijon mundësinë që studentët e programit MSC “Financë” kanë mundësinë e ankimimit, rishikimit dhe deri në reflektim e ndryshimit të vlerësimit edhe për rezultatin përfundimtar të provimit. Këto kryhen bazuar në Rregulloren e UNIKO, kreu VI, nenet 100-105.</p>

	<p><i>Gjithashtu studentët e pyetur gjatë vizitës në IAL, u shprehën se kurdo që kanë pasur ankimim të rezultatit apo nevojën për rishikim, kjo është mundësuar nga pedagogët brënda kohës prej 48 orësh.</i></p> <p>Në fund të vitit akademik 2020-2021, Departamenti i Financë-Kontabilitetit nisi procesin e rishikimit periodik të programeve të studimit, duke organizuar një tryezë të rumbullakët më 28 qershor 2021, e cila u pasua nga dy mbledhje të tjera. Referuar GVB përmbledhja e propozimeve paraqitet në evidencën (shtojcën 3.22) për përmirësimet e mundshme të programeve të studimit, duke përfshirë programin Master i Shkencave në Financë, por nga GVJ në këtë evidencë nuk u konstatuan analiza dhe përmbledhje propozimesh përsa kërkohet e citohet në RVB.</p> <p><i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"; Shtojca 1.18 Rregullorja për Organizimin e Zgjedhjeve në UNIKO; Shtojca 1.11 Rregullorja e Senatit Akademik; Shtojca 1.19 Kodi i Etikës së UNIKO; Lista e anëtarëve të Këshillit të Etikës, i Këshillit studentor të UK-së, Lista e anëtarëve të Njesisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, dhe Lista e Anëtarëve të Bordit të Administrimit gjenden në website të UNIKO; Shtojca 1.20 Rregullorja e Bordit të Administrimit; Shtojca 3.22 Propozime të diskutuara në mbledhjen e departamentit]</i></p>		
Konkluzione	<p><i>GVJ konkludon se UNIKO përfshin studentët në vlerësimin e procesit akademik bazuar në rezultate të matshme përmes marrjes së mendimit të studentëve të UNIKO me pyetësorët që përgatit dhe organizon NJBSC për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi, dhe konkretisht edhe për programin mësimor Master Shkencor në "Financë".</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Në respekt të kërkesave ligjore, UNIKO ka në organigramë Drejtorinë e Kurrikulave Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor e cila ka në përbërje disa njësi, si Qendrën e Karrierës dhe Alumni (QKA). Këto njësi kanë për qëllim për të mbajtur të informuar, këshilluar dhe ndjekur përparimin e studentëve. Gjithashtu, pranë FE, ndodhet Sekretaria mësimore dhe Sekretaria e departamentit të cilat luajnë një rol aktiv në plotësimin e kërkesave të studentëve në kohën e duhur.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional	

një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional (DKVI), Kreu I, Neni 4, përcakton se pjesë e aktiviteteve të DKVI është edhe monitorimi i zhvillimit profesional të të diplomuarve në UNIKO. Përgjegjësia kryesore për këtë i takon QKA-s, siç është përcaktuar në rregulloren përkatëse, Kreu III, Neni 9, pika 7, Neni 10, pika 4 dhe pika 19. Kështu, QKA mbledh, përpunon dhe ruan të dhëna mbi nivelin dhe cilësinë e punësimit të studentëve, pavarësisht se këto të dhëna duket sikur kërkohen të mblidhen e përpunohen edhe nga njësia për sigurimin e brendshëm të cilësisë pranë Fakultetit të Ekonomisë bazuar në Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Ekonomisë, Kreu XIII, Neni 103, pika 2, ku përcaktohet se edhe njësia për sigurimin e brendshëm të cilësisë pranë Fakultetit të Ekonomisë realizon studime për të ndjekur dhe vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga fakulteti. Në fakt të dhënat në tabelën 23 nuk janë optimiste për punësimin e tyre. Të dhënat e publikuara në website të UNIKO janë deri në vitin akademik 2021-2022.</p> <p><i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"; Baza e të dhënave për gjurmimin e studentëve të diplomuar në website https://unkorce.edu.al/qka-statistika-2/; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit shkencor.]</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>				
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>				
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konsideron se kriteret plotësohen duke pasë në konsideratë disa këshilla të evidentuara edhe në standardin V.4.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

61




Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Bazuar ne RVB dhe viziten ne institucion, GVJ vlereson se, UNIKO në zbatim të detyrimit të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, pika 1, Statutin dhe Rregulloren e Institucionit, ka hartuar politika si dhe ka ngritur struktura në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë duke përfshirë edhe programin MSC ne "Financë".</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë UNIKO i ka specifikuar në Manualin e Sigurimit të Cilësisë, miratuar me Vendimin nr.300, datë 10.07.2020 të Senatit Akademik. Për të pasqyruar parimet kryesore mbi funksionimin e strukturës së sigurimit të cilësisë, institucioni ka hartuar Manualin e Cilësisë, i cili miratohet nga Senati Akademik. Ky manual ofron udhëzime për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, duke siguruar përputhshmërinë me standardet akademike. Njesia përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë është NJSBC e cila si strukture është e parapare ne Statutin e UNIKO. Gjithashtu, politika për sigurimin e cilësisë ne UNIKO ishte publike së bashku me Planin Strategjik ku ishin të parashtruara politikat dhe procedurat që do të ndjekë institucioni në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. NJSBC përbëhet nga përfaqësues nga çdo njësi kryesore, studentë dhe ekspert i jashtëm.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Sipas RVB, nga GVB bëhet vlerësim i brendshëm i programit të studimit si rregull një herë në vit të cilat përdoren si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe për vlerësimin e jashtëm. Por, <i>GVJ nuk konstaton evidenca se çfarë masash janë marr në rast të gjetjes së mospërputhjeve në plotësimin e standardeve të cilësisë sipas manualit, për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga Bordi ASCAL, apo ato të KLSH-së.</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Sipas kuadrit ligjor e rregullator të UNIKO, studentët kanë një rol të rëndësishëm në veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe financiare të tij. Atyre ju jepen të drejta të jenë aktivisht të përfshirë në vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies, vlerësimeve të stafit dhe shërbimeve, përmes pyetësorëve dhe mekanizmave të strukturuar që u lejojnë të shprehin mendimet e tyre dhe të trajtojnë ankimet në mënyrë transparente. Po ashtu, ata janë të pranishëm në struktura që garantojnë cilësinë, përfshirë: Senatin Akademik, me dy anëtarë studentë; Këshillin e Etikës, me një përfaqësues student; Bordin e Administrimit, ku një anëtar votohet nga studentët; Komisioni NJSBC për sigurimin e cilësisë dhe akreditimin.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel njesie kryesore bëjnë publike të dhënat e tyre nëpërmjet raporteve vjetore.</p>

	<p>NJSBC-ja gjithashtu harton Raportet e Vlerësimit të Brendshëm. Ky raport si rregull paraqet rezultatet e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë edhe për këtë program studimi të ofruar nga UNIKO. UNIKO ka të publikuar në website disa raporte periodike që përmbajnë të dhëna mbi performancën e mësimdhënies. Këto raporte janë të aksesueshme për studentët, stafin dhe publikun e gjerë. Kjo mundëson që të gjitha palët e interesuara të monitorojnë dhe vlerësojnë përparimin e cilësisë, duke promovuar transparencën dhe angazhimin në proceset akademike.</p> <p><i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"; Shtojca 1.16 Manuali i Cilësisë së UNIKO; Shtojca 4.14 Vendim mbi NJSBC; Shtojca 3.7 Raport Vlerësimi i Brendshëm (NJSBC); Shtojca 3.13 Pyetësor studentor fundkursi; Shtojca 3.14 Pyetësor i Stafik Akademik; Shtojca 3.9 Analiza vjetore e Veprimtarisë së Fakultetit të Ekonomisë; Shtojca 2.20 Analiza e Veprimtarisë UNIKO]</i></p>		
Konkluzione	<p>GVJ nuk konstaton evidenca se çfarë masash janë marr për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga Bordi ASCAL, të KLSH-së, apo ato të NJSBC. GVJ rekomandon që NJSBC të mbaj evidenca për të reflektuar ndjekjen e plotësimit të rekomandimeve të dhëna nga raportet e posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, etj.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>GVJ evidenton se DFK është njësi kryesore qe duhet të marrë përsipër të drejtën dhe detyrimin për përmirësimin dhe rishikimin e programit mësimor. Ndërsa, NJSBC-ja vepron ne nivel institucional dhe eshte pergjegjese per monitorimin e cilesise ne te gjithe programet e studimit. Në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë dhe Statutin e Universitetit "Fan S. Noli" të Korçës, institucioni është përgjegjës për zhvillimin e politikave dhe procedurave të sigurimit të cilësisë brenda tij. Organet kolegjiale, përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre, hartojnë politikat, strukturat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë. Referuar RVB, UNIKO ka përcaktuar standardet e tij për sigurimin e cilësisë, të cilat janë të përputhshme me Kodin e Cilësisë të Arsimit të Lartë, hartuar nga ASCAL dhe MAS. Manuali i Sigurimit të Cilësisë është miratuar me Vendimin nr. 300, datë 10.07.2020, nga Senati Akademik dhe përmban procedurat dhe parimet themelore që udhëhoqen nga ky</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe</p>	

bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	sistem. Në përputhje me Planin Strategjik 2022-2027, të miratuar nga institucioni, janë përcaktuar politikat dhe procedurat për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Sipas Statutit të UK, është hartuar gjithashtu Manuali i Cilësisë i UNIKO, i cili përcakton se si funksionon struktura e cilësisë në UNIKO dhe respekton kuadrin ligjor dhe përgjithësisht sistemin e sigurimit të cilësisë. Ky manual është një dokument i rëndësishëm që përshkruan kornizën, strukturat, parimet, procedurat dhe standardet e sigurimit të cilësisë dhe është i integruar në punën e përditshme të stafit të UNIKO.			
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Gjithashtu, referuar RVB, evidentohet se në fund të vitit akademik, njësitë bazë realizojnë vlerësime për performancën e stafit akademik dhe për punën kërkimore shkencore, të cilat përfshihen në Raportin Vjetor që analizohet dhe dërgohet më pas për analizë në nivel fakulteti. Ky proces është një pjesë e rëndësishme e përpjekjeve për të përmirësuar vazhdimisht cilësinë dhe mësimdhënien në UNIKO.			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësi, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	<p><i>Në RVB mungojnë link për publikimin online të raporteve të vlerësimit të cilësisë. Megjithatë ekspertët e vlerësimit të jashtëm në website të UNIKO gjejnë të vendosur disa raporte dhe e vlerësojnë këtë si një praktikë të mirë në plotësim të transparencës për pretendentët. GVJ i rekomandon Senatit Akademik, dhe Bordit të Administrimit të UNIKO të kërkojnë një analizë (follow up) të zbatimit të detyrave apo masave për adresimin e gjetjeve, mangësive dhe rekomandimeve të evidentuara nga këto raporte për përmirësimin në vijim të cilësisë.</i></p> <p><i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"; Shtojca 1.1 Statuti I UNIKO; Shtojca 1.16 Manuali i Cilësisë UNIKO; Shtojca 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO 2022-2027; Shtojca 2.2 Rregullorja e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë; Biblioteka gjendet online ne website të UNIKO; Shtojca 4.14 Vendim mbi NJSBC; Shtojca 3.9 Analiza vjetore e Veprimtarisë së Fakultetit të Ekonomisë.]</i></p>			
Konkluzione	GVJ vlerësojnë si një praktikë të mirë në plotësim të transparencës për pretendentët e UNIKO publikimin prej tyre të raporteve të vlerësimit të brendshëm dhe disa analiza të gjetjeve nga përgjigjet e pyetësorëve të studentëve. GVJ i rekomandon Senatit Akademik, dhe Bordit të Administrimit të UNIKO të kërkojnë një analizë (follow up) të zbatimit të detyrave apo masave për adresimin e gjetjeve, mangësive dhe rekomandimeve të evidentuara nga këto raporte për përmirësimin në vijim të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>UNIKO ka përgjegjësinë t'i ofrojë shoqërisë shqiptare një cilësi të lartë të programeve mësimore, të tregojë se po bën përpjekjet e mundshme për të përdorur në mënyrë efektive dhe efikase burimet e siguruara nga buxheti i shtetit, studentët e saj, etj., dhe të sigurojë që janë plotësuar standardet e cilësisë. GVJ konkludon se raportet dhe vlerësimet e NJSBC bëhen në nivel institucional dhe nuk konstatohet të ketë vlerësim nga NJSBC për këtë program specifikisht, por nga analiza e përgjithshme institucionale, DFK evidenton elementet që lidhen me programin MSC "Financë".</p> <p>Me qëllim rritjen e cilësisë për këtë program studimi, UNIKO ka përdorë disa metoda dhe instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të këtij programi studimi. Të tilla janë: sondazhe dhe intervista me studentët aktuale, me ato të diplomuar (alumni), me personelin akademik, ndihmes akademik e administrativ.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Referuar RVB-së, në nivel fakulteti ka pasur vetëvlerësim po nuk ka pasur vlerësime të jashtme dhe auditime. Njësia bazë në mënyrë të përvitshme harton raportet e veprimtarisë institucionale të cilat përfshijnë analizën e procesit mësimor dhe atë të kërkimit shkencor me të gjithë komponentët e vlerësimit të tyre. Nga analiza e vlerësimeve janë nxjerrë rekomandime dhe janë lënë detyra në lidhje me rregullsinë e procesit mësimor dhe cilësinë e mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime</p>	<p>Referuar GVB, evidentohet se NJSBC ofron mbështetje dhe ekspertizë për fakultetet dhe departamentet, duke realizuar vizita të rregullta dhe duke ofruar këshilla mbi zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë. Ekspertiza e ofruar është e përqendruar kryesisht në implementimin e mekanizmave të cilësisë për mësimdhënie, vlerësim dhe përfshirjen e studentëve në procesin e të nxëniet. NJSBC koordinon komunikimin ndërmjet strukturave të ndryshme të universitetit, veçanërisht në rastet kur proceset i delegohen fakulteteve ose kur ka vlerësime të organizuara nga Universiteti. Ky rol koordinues shtrihet edhe në njësitë e tjera të Universitetit që janë të përfshira në zhvillimin e personelit dhe mbledhjen/analizën e të dhënave institucionale. NJSBC siguron që detyrimet kombëtare dhe evropiane për sigurimin e cilësisë të adaptohen dhe zbatohen në kontekstin e Universitetit. Anëtarët e NJSBC sigurojnë që këto detyrime të përfshihen në politikat dhe praktikat e universitetit.</p> <p>NJSBC monitoron dhe ofron udhëzime për mbledhjen e të dhënave dhe evidentimin e problemeve që paraqiten, duke i dërguar ato në njësitë përkatëse për t'u trajtuar. NJSBC gjithashtu organizon vizita të vlerësimit të jashtëm dhe fton ekspertë të jashtëm për të trajnuar stafin që merret me vlerësimin e brendshëm. Për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit të nivelit të dytë "Master i Shkencave" në</p>

<p>ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>“Financë”, përdoren disa metoda vlerësimi, duke përfshirë vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies që realizohet përmes metodave të kontrollit të dijeve, duke përfshirë testime të ndërmjetme, diskutime, studime rasti, ese, detyra dhe projekte. Vlerësimet paralele të provimeve kryhen kur ka ankesa nga studentët.</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerëimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p><i>Ndërsa në përfundim, GVJ evidenton se QKA duhet të përditësojë të dhënat mbi studentët e diplomuar dhe punëdhënësit për të siguruar informacion të përditësuar mbi tregun dhe nevojat e tij.</i></p> <p><i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 “RVB e MSC Financë”; Shtojca 2.20 Analiza e veprimtarisë UNIKO; Shtojca 3.7 Raport Vlerësimi i Brendshëm (NJSBC); Shtojca 3.9 Analiza vjetore të Veprimtarisë së Fakultetit të Ekonomisë; Shtojca 1.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DKVI; Shtojca 2.2 Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë.]</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson punën e bërë dhe këshillon IAL-në që përveç metodave që ai aplikon mund të përdorë edhe metoda dhe instrumenta të tjera si psh vlerësimi 360 gradë. Gjithashtu, GVJ ka cituara edhe më herët se QKA duhet të përditësojë të dhënat mbi studentët e diplomuar dhe punëdhënësit për të siguruar informacion të përditësuar mbi tregun dhe nevojat e tij.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>Bazuar në Statutin e UNIKO, Manualin e Cilësisë, Rregulloren e FE, etj., percaktohen njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë për programet e studimit. Manuali i Cilësisë së UNIKO-së është një udhëzues i rëndësishëm që përshkruan qartë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm të përfshirë në procesin e sigurimit të cilësisë, duke specifikuar detyrat, përgjegjësitë dhe rolet e tyre. Gjithashtu, për të vlerësuar progresin e programeve, Departamenti dhe Fakulteti realizojnë analizat periodike të aktiviteteve të tyre. Gjetjet dhe sfidat që dalin</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>diskutohen në mbledhje të hapura të Departamentit dhe Fakultetit, me pjesëmarrjen aktive të anëtarëve të stafit akademik, ndihmës akademik dhe atij administrativ. Studentët kanë një rol të rëndësishëm në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë, duke kontribuar dhe duke u përfshirë në struktura të ndryshme të Universitetit dhe Fakultetit përmes përfaqësuesve të tyre.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p><i>Por studentët e pyetur gjatë vizitës në IAL, për përfaqësuesit e tyre në këto struktura, u shprehëse nuk kishin dijeni se kush i përfaqësonte. GVJ i sugjeron IAL-së: Pas çdo lloj vlerësimi dhe analize duhet të merren masat e nevojshme konkrete të përcaktuara në kohë për tu zbatuar dhe pas çdo semestri të vlerësohet progresi apo regresi dhe axhustimet e nevojshme që duhen bërë. Si edhe, të evidentojnë Strategjitë për rritjen e numrit të studentëve në këtë program studimi përmes ruajtjen së cilësisë bazuar në analizën e zhvillimeve dhe nevojave të ekonomisë dhe shoqërisë në rrafshin lokal, rajonal, dhe kombëtar brënda kapaciteteve të UNIKO, mundësisë për mbështetje me fonde dhe tarifa, si edhe marrjes në konsideratë të orientimit strategjik të përgjithshëm kombëtar.</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimin duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimin dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p><i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"; Shtojca 1.16 Manuali i Cilësisë së UNIKO; Shtojca 2.4 Plani Strategjik i Zhvillimit e FE; Shtojca 3.9 Analiza Vjetore e Veprimtarisë së Fakultetit të Ekonomisë; Shtojca 3.26 Marrëveshje Bashkëpunimi Departamenti Finance-Kontabilitet dhe Institucioneve të tjera]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se studentët e këtij programi studimi nuk kishin dijeni se kush i përfaqësonte në strukturat e tyre qeverisëse. GVJ i sugjeron IAL-së: Pas çdo lloj vlerësimi dhe analize duhet të merren masat e nevojshme konkrete të përcaktuara në kohë për tu zbatuar dhe pas çdo semestri të vlerësohet progresi apo regresi dhe axhustimet e nevojshme që duhen bërë. Si edhe, të evidentojnë Strategjitë për rritjen e numrit të studentëve në këtë program studimi përmes ruajtjen së cilësisë bazuar në analizën e zhvillimeve dhe nevojave të ekonomisë dhe shoqërisë në rrafshin lokal, rajonal, dhe kombëtar brënda kapaciteteve të UNIKO, mundësisë për mbështetje me fonde dhe</i></p>

	<i>tarifa, si edhe marrjes në konsideratë të orientimit strategjik të përgjithshëm kombëtar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Bazuar ne RVB, informacioni në lidhje me politikat dhe praktikat që lidhen me sigurimin e cilësisë në UNIKO janë të aksesueshme nga i gjithë komuniteti brenda universitetit përfshi edhe studentët duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Gjithashtu, politikat dhe strategjia mbi të cilat funksionon sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë të harmonizuara me Planin Strategjik të Zhvillimit të UNIKO. Organizimi dhe aktivitetet që realizohen në kuadër të sigurimit të cilësisë janë të rregulluara dhe dokumentuara në Statutin e UNIKO, Rregulloren e UNIKO, Manualin e Cilësisë të UNIKO dhe Rregulloren e Brendshme të FE. Të gjitha këto dokumente janë të disponueshme për publikun në faqen zyrtare të UNIKO. NJSBC përgatit dhe publikojnë rregullisht raporte të brendshme vlerësimi, të cilat ruhen në arkivat e FE dhe UNIKO dhe janë të disponueshme për palët e interesuara.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<i>GVJ konstaton se UNIKO publikon rezultatet e vlerësimeve të brendshme të cilësisë së programeve të studimit, duke siguruar respektimin e lirisë akademike dhe etikës, si dhe duke u përpjekur të mbajë të dhënat personale në përputhje me rregulloret për mbrojtjen dhe përpunimin e këtyre të dhënave. Por, GVJ nuk konstaton në RVB për këtë IAL se ka respektuar kërkesat e standardeve duke siguruar transparencë për publikimin edhe në faqen web të UNIKO të të gjitha Relacioneve Përmbledhëse për analizat e rezultateve të pyetësorëve nga anketimi i studentëve (me përfshirje të vitit akademik 2022-2023, si edhe disa raporte me të dhëna semestrale).</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Departamenti i Financës-Kontabilitetit, FE dhe UNIKO realizojnë vlerësime të rregullta të rezultateve të aktiviteteve mësimore dhe kërkimore-shkencore. Raportet e përgatitura reflektojnë arritjet në mësimdhënie dhe kërkim gjatë një viti akademik, si dhe sfidat që mund të hasen në aspekte të caktuara të tyre. Pasi të identifikohen nevojat për përmirësim në këto analiza, Departamenti harton një plan veprimi vjetor për të përmirësuar cilësinë e programeve të studimit, i cili përcakton detyrat specifike, përgjegjësitë dhe afatet për realizimin e qëllimeve. FE informon dhe ndërgjegjëson stafin akademik,
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	

	<p>administrativ dhe studentët mbi rëndësinë e sigurimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit.</p> <p>UNIKO monitoron dhe siguron efektivitetin e veprimtarive që lidhen me vlerësimin e cilësisë, duke përfshirë përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, sipas rregulloreve të përcaktuara në Statutin e UK dhe Rregulloren e UNIKO.</p> <p>Takimet e Asamblesë së FE dhe ato të anëtarëve të Departamentit janë të rëndësishme për të informuar personelin mbi arritjet dhe vlerësimet e programeve të studimit dhe për të identifikuar nevojat për përmirësim. Takimet midis Dekanatit dhe Këshillit Studentor janë të dedikuara për të marrë opinionet e studentëve lidhur me ndryshimet në programet e studimit, metodologjinë e mësimdhënies, metodat e vlerësimit dhe cilësinë e shërbimeve. Organizimi i pyetësorëve studentor ka për qëllim jo vetëm vlerësimin e cilësisë, por edhe ndërgjegjësimin e studentëve për rëndësinë e procesit të sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca: [Dokumentat 1, 2, 3, 4 "RVB e MSC Financë"; Shtojca 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO; Shtojca 1.1 Statuti UK; Shtojca 1.2 Rregullorja e UNIKO; Shtojca 1.16 Manuali i Cilësisë së UNIKO; Shtojca 2.2 Rregullorja e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë; Shtojca 1.19 Kodi i Etikës së UNIKO; Shtojca 1.9 Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale; Shtojca 2.4 Plani Strategjik i Zhvillimit 2022-2027 Fakulteti i Ekonomisë; Linku: https://unkorce.edu.al/26223-2/]</i></p>								
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se UNIKO publikon rezultatet e vlerësimeve të brendshme të cilësisë së programeve të studimit, duke siguruar respektimin e lirisë akademike dhe etikës. Por, GVJ këshillon UNIKO të publikoj të gjitha Relacioneve Përmbledhëse për analizat e rezultateve të pyetësorëve nga anketimi i studentëve.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="544 1323 727 1402">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="727 1323 911 1402">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="911 1323 1094 1402">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1094 1323 1294 1402">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="544 1402 727 1444"></td> <td data-bbox="727 1402 911 1444"></td> <td data-bbox="911 1402 1094 1444"></td> <td data-bbox="1094 1402 1294 1444" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




**Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i
Shkencave në “Financë” të ofruar nga institucioni i arsimit të lartë Universiteti
“Fan S. Noli”, Korçë**

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe njësisë bazë përgjegjëse, për këtë program studimi. *(Standardi I.2)*
2. Njësia kryesore dhe njësia bazë, përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi, përmbushin kërkesat ligjore. *(Standardi II.2)*
3. Qëndrueshmëria e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, për të gjithë periudhën e akreditimit, me kontrata pa afat të punësimit dhe shlyerjen e detyrimeve financiare. *(Standardi IV.1)*
4. Vënia në dispozicion e bibliotekave që institucioni zotëron në përdorim të komunitetit jashtë IAL-së duke mundësuar publikut përdorimin e tyre. Kjo konsiderohet si praktikë pozitive për të krijuar lidhje me pretendentët jashtë IAL-së. *(Standardi IV.3)*
5. IAL siguron transparencë përmes publikimit në website të tij, të raporteve të vlerësimit të brendshëm dhe disa analiza të gjetjeve nga përgjigjet e pyetësorëve të studentëve. *(Standardi VI.2)*

Pika të dobta:


1. Programi i studimit ka një shpërndarje të krediteve në kategoritë A, C dhe E, të cilat nuk ruajnë balancën ndërmjet disiplinave përkatëse. *(Standardi II.1)*
2. Mungesa e një studimi të plotë të tregut të punës, me fokus në mundësitë e punësimit në fushën e financës dhe në institucionet financiare për studentët e këtij programi studimi. *(Standardi II.5)*
3. Niveli i ulët i angazhimit të njësisë bazë përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi dhe i personelit akademik, në aktivitete shkencore dhe botime të publikuara në revista shkencore të indeksuara me faktor impakti, si edhe mungesa e përfshirjes së studentëve të këtij programi studimi, në projekte kërkimore dhe në veprimtari akademike shkencore. *(Standardi II.7; Standardi IV.1)*
4. Angazhim në mësimdhënie në këtë program studimi i personelit akademik që nuk ka tituj akademik apo gradë shkencore ka krijuar mospërputhje me kërkesat ligjore në fuqi. *(Standardi IV.1)*
5. Mungesa e literaturës bazë, qoftë edhe në versionin e ciklit të leksioneve në formatin fizik, në funksion të këtij programi studimi. *(Standardi IV.3)*
6. Mosadresimi i rekomandimit të dhënë nga KLSH për marrjen e masave për adresimin e gjetjeve sipas raportit përfundimtar të auditimit (2023): “IAL-të duke mos e njohur Rezolutën 2001/C 204/02, e njohur si Rezoluta mbi E-Learning e

miratuar nga Këshilli i Ministrave të vendeve anëtare të BE-së...dëshmojnë se kanë mangësi lidhur me informacionin që lidhet me praktikën e e-learning...".
(Standardi IV.4)

7. Mungon analiza e kostos për student për këtë program studimi me qëllim kryerjen e analizave të nevojshme për mirëmenaxhimin e fondeve të marra nga buxheti i shtetit dhe orientimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturën e UNIKO në arritjen e misionit të tij përmes analizës dhe përcaktimit të strategjive konkrete për çdo njësi bazë dhe program studimi. Ndërkohë që kosto mesatare për student "Grant i Buxhetit të Shtetit" ka tendencë rritje. **(Standardi IV.5)**
8. Mungesa e një strategjie të aplikueshme për rritjen e numrit të studentëve në këtë program studimi përmes ruajtjen së cilësisë. **(Standardi VI.4)**

Rekomandime:

1. Institucioni, të rishikojë shpërndarjen e krediteve në kategoritë A, C dhe E, për të ruajtur balancën ndërmjet disiplinave përkatëse. **(Standardi II.1)**
2. Institucioni, të realizojë një studim të plotë të tregut të punës, me fokus në mundësitë e punësimit në fushën e financës dhe në institucionet financiare për studentët e këtij programi. **(Standardi II.5)**
3. Institucioni, të marrë masa për rritjen e mbështetjes së personelit akademik dhe studentëve të këtij programi studimi, në kuadër të publikimit në revista me faktor impakti, pjesëmarrjes në aktivitete kërkimore shkencore dhe përfshirjen e studentëve në këto aktivitete. **(Standardi II.7; Standardi IV.1)**
4. Institucioni, të marrë masa që kualifikimi i personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi të jetë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. **(Standardi IV.1)**
5. Institucioni, të përditësojë menjëherë bibliotekën me literaturë bazë, qoftë edhe në versionin e ciklit të leksioneve në formatin fizik për këtë program studimi. **(Standardi IV.3)**
6. Institucioni, të adresojë rekomandimin e dhënë nga KLSH për marrjen e masave për adresimin e gjetjeve sipas raportit përfundimtar të auditimit (2023): "IAL-të duke mos e njohur Rezolutën 2001/C 204/02, e njohur si Rezoluta mbi E-Learning e miratuar nga Këshilli i Ministrave të vendeve anëtare të BE-së...dëshmojnë se kanë mangësi lidhur me informacionin që lidhet me praktikën e e-learning...". **(Standardi IV.4)**
7. Të kryhet analiza e kostos për student për programin e studimit me qëllim kryerjen e analizave të nevojshme për mirëmenaxhimin e fondeve të marra nga buxheti i shtetit. **(Standardi IV.5)**
8. Të hartohet një strategji e aplikueshme për rritjen e numrit të studentëve në këtë program studimi përmes ruajtjen së cilësisë bazuar në analizën e zhvillimeve dhe nevojave të ekonomisë dhe shoqërisë në rrafshin lokal, rajonal, dhe kombëtar



brënda kapaciteteve të UNIKO, mundësisë për mbështetje me fonde dhe tarifa, si edhe marrjes në konsideratë të orientimit strategjik të përgjithshëm kombëtar. **(Standardi VI.4)**

9. Institucioni, të përditësojë në mënyrë periodike përmbajtjen e lëndëve dhe moduleve të këtij programi studimi, duke u bazuar në zhvillimet më të fundit të tregut financiar. Kjo do të mundësojë një përshtatje më efektive të programit me kërkesat dinamike të tregut të punës dhe rritjen e relevancës së tij për formimin profesional të studentëve. **(Standardi II.1 dhe II.3)**
10. Institucioni, të përshtasë formatin e syllabuseve të këtij programi studimi, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. **(Standardi II.3)**
11. NJSBC të mbajë evidenca për të reflektuar ndjekjen e plotësimin të rekomandimeve të dhëna nga raportet e posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, etj. **(Standardi VI.1)**

**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Science in
"Finance" provided by the higher education institution University "Fan S. Noli"
Korça**

Strengths and affirmations:

1. The study program aligns with the academic field of the main and responsible base units for this study program. *(Standard I.2)*
2. The main and base units responsible for offering this study program meet the legal requirements. *(Standard II.2)*
3. Stability of the academic staff engaged in this study program for the entire accreditation period, with indefinite employment contracts and fulfillment of financial obligations. *(Standard IV.1)*
4. The provision of the institution's libraries for use by the community outside the higher education institution (HEI), enabling public access. This is considered a positive practice to build links with external stakeholders. *(Standard IV.3)*
5. The HEI ensures transparency by publishing on its website internal evaluation reports and analyses of findings from student questionnaire responses. *(Standard VI.2)*

Weaknesses:


1. The distribution of credits in categories A, C, and E within the study program does not maintain a proper balance between respective disciplines. *(Standard II.1)*
2. Lack of a comprehensive labor market study focusing on employment opportunities in the field of finance and financial institutions for students in this study program. *(Standard II.5)*
3. Low level of involvement by the responsible base unit and academic staff in scientific activities and publications in indexed scientific journals with impact factors, as well as lack of student participation in research projects and academic scientific activities. *(Standards II.7; IV.1)*
4. Engagement of academic staff without academic titles or scientific degrees in teaching in this program has resulted in non-compliance with the current legal requirements. *(Standard IV.1)*
5. Absence of basic literature, even in the form of printed lecture cycles, necessary for the support of this study program. *(Standard IV.3)*
6. Failure to address the recommendation from the State Supreme Audit Institution (KLSH) to take measures based on the final audit report (2023): "HEIs, by not acknowledging Resolution 2001/C 204/02, known as the E-Learning Resolution adopted by the Council of Ministers of EU member states... demonstrate shortcomings in information related to e-learning practices...". *(Standard IV.4)*

7. Absence of a cost-per-student analysis for this study program, which is essential for the effective management of state budget funds and strategic orientation of human resources and infrastructure at UNIKO toward its mission through strategic planning per base unit and program. Meanwhile, the average cost per student from the "State Budget Grant" shows an increasing trend. *(Standard IV.5)*
8. Lack of an applicable strategy for increasing student numbers in this study program while maintaining quality. *(Standard VI.4)*

Recommendations:

1. The institution should review the distribution of credits in categories A, C, and E to maintain balance between respective disciplines. *(Standard II.1)*
2. The institution should conduct a comprehensive labor market study focusing on employment opportunities in the field of finance and financial institutions for students of this program. *(Standard II.5)*
3. The institution should take measures to increase support for academic staff and students in this program regarding publication in impact factor journals, participation in scientific research activities, and student involvement in these activities. *(Standards II.7; IV.1)*
4. The institution should ensure that the qualifications of the academic staff engaged in this study program comply with current legal provisions. *(Standard IV.1)*
5. The institution should immediately update the library with basic literature, even in the form of printed lecture cycles for this study program. *(Standard IV.3)*
6. The institution should address the recommendation given by KLSH regarding the adoption of measures to respond to findings from the final audit report (2023): "HEIs, by not acknowledging Resolution 2001/C 204/02, known as the E-Learning Resolution adopted by the Council of Ministers of EU member states... demonstrate shortcomings in information related to e-learning practices...". *(Standard IV.4)*
7. A cost-per-student analysis should be conducted for this study program to perform the necessary evaluations for effective management of state budget funds. *(Standard IV.5)*
8. A feasible strategy should be developed for increasing the number of students in this study program while maintaining quality, based on an analysis of economic and social developments and needs at local, regional, and national levels, within UNIKO's capacities, funding and tuition support possibilities, and in alignment with the overall national strategic orientation. *(Standard VI.4)*
9. The institution should periodically update the content of subjects and modules in this study program, based on the latest developments in the financial market. This would enable more effective alignment of the program with dynamic labor market demands and enhance its relevance to students' professional training. *(Standards II.1 and II.3)*

10. The institution should adapt the syllabi format of this study program in compliance with current sub-legal acts. *(Standard II.3)*
11. The Internal Quality Assurance Unit (NJSBC) should maintain records to reflect the follow-up of implementation of recommendations from special reports on the quality assurance of study programs, as part of the internal quality assurance system structures. *(Standard VI.1)*



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përbushe n pjesërisht	Përbushe n kryesisht	Përbushe n plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X